

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

SHËRBIME BANKARE

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit IV në KEK²

(2 vjeçar)

Kodi: L3-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

2.Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar).**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**
- XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e bankave. Zhvillimi të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë, metodologjitë e proceset bashkëkohore e të perspektivës në fushën e ekonomi-biznesit dhe të administrimit, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve që ndjekin kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë përfunduar një kualifikim profesional në fushën “Ekonomi-biznes”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- nëse kanë aftësi ndryshe, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelet e mëparshme, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të respektojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët.
- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit, duke përdorur terminologji profesionale.
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, duke zbatuar rregullat e higjienës.
- Të menaxhojë burimet materiale dhe mjetet e nevojshme për shërbime ndaj klientit.
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për sistemin bankar.
- Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave, sipas procedurave.
- Të kryejë çeljen dhe mbylljen e arkës, sipas procedurave.
- Të kryejë shërbime bankare ndaj klientit, sipas procedurës.
- Të kryejë përpunimin e kesh-it, sipas procedurës.
- Të këshillojë klientin për produktet/shërbimet bankare të ofruara përmes kanaleve digjitale.
- Të ruajë integritetin e të dhënave, sipas politikave të sigurisë së bankës.
- Të kryejë procedurat për rastet e dyshimta, duke respektuar politikën për parandalimin e pastrimit të parave (AML).
- Të zbatojë rregulloren e Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave, sipas legjislacionit.
- Të zbatojë legjislacionin tatimor në fuqi dhe kodin e punës.
- Të kryejë veprime financiare.
- Të zbatojë teknikat e marketingut për produktet/shërbimet e kryera.
- Të ndjekë trajnime për zhvillimin e vazhduar profesional.
- Të bashkëpunojë me të tjerë, duke zbatuar parimet e punës në grup.
- Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë.

- Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit në mjedisin e punës.
- Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës e nivelit teknik/menaxherial në këtë fushë. Ky kualifikim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në sektorin e shërbimeve ndaj klientit në institucione bankare, në institucione financiare jobanka, në institucione të pagesave, në institucione të parasë elektronike, si dhe zyra të këmbimit valutor.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.

III. Plan i mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK

Plan i mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	10/11 (360/ 396)	14/15 (448/ 480)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	2
7		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1	1
8		Gjeografi	1	-
9		Biologji	-	2
10		Fizikë	-	1
11		Shkenca sociale	-	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (288)	10 (320)
1	L-17-253-25	Bankat dhe sistemi financiar	2	-
2	L-17-255-25	Teknika bankare	3	2
3	L-17-635-23	Ekonomi e përgjithshme	3	2
4	L-17-256-25	Kontabiliteti bankar	-	3
5	L-17-228-25	E drejta dhe legjislacioni	-	2

6	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	9 (324)	6 (192)
1	M-17-2184-25	Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime bankare	36	-
2	M-38-2185-25	Komunikimi dhe etika profesionale në bankë	54	-
3	M-17-2186-25	Çelja dhe mbyllja e arkës	78	-
4	M-17-2187-25	Përpunimi i Cash-it	78	-
5	M-17-2188-25	Veprimet në shërbime bankare	78	36
6	M-17-2189-25	Veprimet në shërbime bankare digjitale	-	54
7	M-17-1984-23	Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve	-	30
8	M-17-2190-25	Procedurat për rastet e dyshimta	-	30
9	M-17-1590-25	Siguria fizike dhe operacionale në bankë	-	42
D.		Modulet e me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	3 (108)	-
1	M-17-779-25	Kuadrimi ditor i arkës	54	-
2	M-17-781-25	Studimi i tregut bankar	54	-
3	M-26-1580-19	Marketingu digjital	54	-
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/1116)	30/31 (960/992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Skeletkurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për kualifikimet profesionale të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësimdhënësit e lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin

maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësimdhënësit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të nxënit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK.

Mësimdhënësit dhe duhet të përdorin metoda të tilla të të nxënit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimi (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësimdhënësit është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”.

Në rastin e nxënësve me aftësi ndryshe, mësimdhënësit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

Në klasën 12, modulet e praktikës profesionale do të zhvillohen në shkollë ose mjediset e praktikave profesionale e cila imiton një njësi ekonomike apo bankë reale.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësimdhënësit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimit të praktikës profesionale të integruar.
- b) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI).

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në sektorin bankar. Në përfundim, nxënësve u jepet diploma e maturës shtetërore profesionale, si dhe certifikata e përgatitjes profesionale, në të cilat evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike të përgjithshme dhe profesionale, të moduleve të praktikës profesionale dhe të provimeve përfundimtare.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit

profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime bankare”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e maturës shtetërore profesionale, si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional në këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi.

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor.

- rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bankat dhe sistemi financiar” (L-17-253-25). Kl. 12 – 72 orë

• Synimet e lëndës “Bankat dhe sistemi financiar”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bankat dhe sistemi financiar” në kl.12, nxënësit duhet:

- të përkufizojnë kuptimin për bankat;
- të përshkruajnë kuptimin e sistemit bankar, nivelet dhe funksionet e tij;
- të shpjegojnë funksionin dhe rolin e bankave në sistemin financiar;
- të shpjegojnë funksionin e sistemit financiar (banka, institucione të tjera financiare, sigurime, fondet e pensione, tregjet financiare);
- të shpjegojnë funksionimin e korrespondencës midis bankave;
- të tregojnë rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që ndihmojnë në stabilitetin financiar global;
- të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për sistemin bankar;
- të përshkruajnë historikun e zhvillimit të sistemit bankar në Shqipëri;
- të përshkruajnë sistemin bankar në Shqipëri;
- të përshkruajnë rolin e bankave në tregjet financiare, si dhe marrëdhëniet me instrumentet financiare si obligacionet, aksionet etj;
- të përshkruajnë punën e shërbimit të klientit në institucione financiare;
- të dallojnë veçoritë e tregut financiar jo-bankar nga ai bankar;
- të përshkruajnë veçoritë e institucioneve financiare jo-bankare (shoqëritë e sigurimeve, fondet e pensione, firmat e investimeve, institucionet mikrofinanciare dhe kompani të tjera financiare që ofrojnë shërbime të ngjashme me bankat, por nuk janë banka);
- të tregojnë rëndësinë e teknologjisë (bankat elektronike, aplikacionet mobile etj) në sistemin bankar;
- të shpjegojnë mënyrat se si teknologjia ka transformuar industrinë bankare dhe sistemin financiar global;
- të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës (çelje dhe mbyllje të sistemeve, komunikimin me bashkëpunëtorët etj);
- të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të makinerive detektuese (të parave të falsifikuara) dhe të numërimit;
- të shpjegojnë rolin dhe rëndësinë që ka menaxhimi i burimeve njerëzore në institucionin financiar;
- të shpjegojnë rëndësinë e respektimit të diversitetit dhe etikës profesionale në komunikimin dhe bashkëpunimin në grup;
- të argumentojnë rëndësinë e vlerësimit, motivimit dhe zgjidhjes së problemeve për performancën dhe karrierën e punonjësve;
- të përshkruajnë mënyrat dhe rëndësinë e bashkëpunimit me kolegët/eporët e tjerë;
- të tregojnë kuptimin dhe rëndësinë e zbatimit të AML-së (Anti-Money Laundering)
- të përshkruajnë procedurat dhe politikat për parandalimin e pastrimit të parave (AML);
- të identifikojnë transaksionet e dyshimta dhe mënyrën e analizimit të riskut mbi identifikimin e tyre;
- të identifikojnë teknikat e menaxhimit të situatës në raste të dyshimta dhe rëndësinë e bashkëpunimit me strukturat e tjera;
- të shpjegojnë rëndësinë e rregullave të Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave;
- të shpjegojnë procedurat e sigurisë në menaxhimin e parave;
- të përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të procedurave të shërbimeve bankare, dokumentacionit dhe ruajtjes së kredencialeve;

- të shpjegojnë rëndësinë e identifikimit të vlerave, sigurimit teknik dhe strukturave të sigurisë;
- të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të manualeve, të mjeteve e pajisjeve të sigurisë teknike;
- të identifikojnë strukturat dhe linjat raportuese të brendshme të institucionit për qëndrime të dyshimta të klientit;
- të përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bankat dhe sistemi financiar”, Kl. 12 – 72 orë**

Tema 1	Bankat dhe roli i tyre	6 orë
Tema 2	Sistemi financiar dhe struktura e tij	6 orë
Tema 3	Rregullat dhe normat ndërkombëtare për bankat	6 orë
Tema 4	Sistemi bankar në Shqipëri	8 orë
Tema 5	Tregjet financiare dhe bankat	8 orë
Tema 6	Tregu financiar jo bankar	6 orë
Tema 7	Institucionet financiare jo-bankare	6 orë
Tema 8	Zhvillimi dhe teknologjia në sistemin bankar	7 orë
Tema 9	Rëndësia e burimeve njerëzore në-institucionet financiare	6 orë
Tema 10	Parandalimi i pastrimit të parave	7 orë
Tema 11	Siguria fizike dhe operationale	6 orë

2. Lënda “Teknika bankare” (L-17-255-25). Kl. 12 - 108 orë dhe Kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “Teknika bankare”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika bankare”, kl. 12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë konceptet bazë të sistemit bankar;
- të listojnë llojet e bankave dhe funksionin e tyre;
- të shpjegojnë rolin e tyre në ekonominë e një vendi;
- të listojnë karakteristikat e bankave tregtare;
- të shpjegojnë rolin e bankave tragtare në ekonominë e një vendi;
- të renditin hapat për çeljen e një llogarie rrjedhëse ose fillimin e marrëdhënies bankë-klient, individ biznes (know your client);
- të listojnë dokumentet e nevojshëm verifikues që duhet të paraqesë klienti për të hyrë në marrëdhënie me bankën;
- të shpjegojnë domosdoshmërinë e vlefshmërisë së tyre për kryerjen e veprimeve bankare;
- të përshkruajnë kuptimin e llogarisë rrjedhëse;
- të shpjegojnë funksionalitetin e një llogarie rrjedhëse, si dhe operationet që mund të kryhen nëpërmjet tyre;
- të shpjegojnë funksionalitetin e një llogarie kursimi, si dhe operationet bankare të cilat mund të kryhen me to;
- të përshkruajnë llojet e depozitave me afat, hapat për çeljen e tyre, si dhe operationet që mund të kryhen me to;
- të listojnë karakteristikat e sigurimit të depozitave;
- të dallojnë llojet e ndryshme të shërbimeve dhe produkteve bankare;
- të identifikojnë operationet e ndryshme bankare që kryhen në degë dhe online;
- të klasifikojnë operationet bankare në varësi të funksionalitetit të tyre;

- të identifikojnë klientët të cilëve do t'i shërbejë dhe t'i ofrojë atyre shërbimet/produktet e duhura;
- të përshkruajnë kartat e debitit ose kreditit;
- të listojnë hapat për pajisjen e klientit me kartë e debiti ose krediti;
- të shpjegojnë mënyrën e funksionimit të kartës së debitit ose kreditit;
- të përshkruajnë shërbimet që ofrojnë bankat përmes kanaleve digjitale;
- të përshkruajnë platformat online që përdor banka (*desktop ose aplikacionin mobile banking*), si dhe operacionet bankare që mund të kryhen me to;
- të përshkruajnë mënyrën e funksionimit të ATM-ve apo pajisjeve të tjera që përdoren nga sistemi bankar;
- të shpjegojnë karakteristikat dhe veçoritë e shërbimeve bankare që lidhen me transfertat e parave;
- të shpjegojnë mënyrën e realizimit të pagesave dhe transfertave, si dhe regjistrimet e nevojshme në sistem;
- të dallojnë karakteristikat e transfertave mes llogarive të të njëjtit klient, mes llogarive të klientëve të ndryshëm brenda bankës, transfertave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare;
- të argumentojnë rëndësinë e likuiditetit të bankave, rezervave të detyrueshme dhe këmbimit valutor;
- të përshkruajnë sistemin e informacionit të administrimit të të dhënave (GDRP);
- të argumentojnë domosdoshmërinë e një sistemi të dhënash eficient dhe të saktë.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika bankare”, Kl. 12 – 108 orë**

Tema 1	Hyrje në sistemin bankar	4 orë
Tema 2	Roli i bankave dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik	5 orë
Tema 3	Aktiviteti bankar dhe funksionet e tij	6 orë
Tema 4	Llogaritë rrjedhëse	8 orë
Tema 5	Llogaritë e kursimit dhe depozitat me afat	8 orë
Tema 6	Produktet bankare	8 orë
Tema 7	Sistemet e pagesave bankare	8 orë
Tema 8	Shërbimet e pagesave dhe të transfertave të parave	8 orë
Tema 9	Shërbimet e ofruara përmes kanaleve digjitale të bankave	6 orë
Tema 10	Kredidhënia bankare	9 orë
Tema 11	Kushtet e kredidhënies	9 orë
Tema 12	Llojet e kredive	8 orë
Tema 13	Menaxhimi i likuiditetit të bankës	8 orë
Tema 14	Siguria dhe privatësia në bankë	8 orë
Tema 15	Cilësia e të dhënave bankare	5 orë

• **Synimet e lëndës “Teknika bankare”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika bankare”, kl. 13, nxënësit duhet:

- të përkufizojnë tregjet financiare dhe llojet e tyre;
- të shpjegojnë produktet komplekse bankare;
- të argumentojnë rolin e kreditit bankar, si mjet për të plotësuar nevojat për financim dhe krijimin e mundësive për individë dhe bizneset;
- të përshkruajnë produktin e kredisë, si dhe regjistrimin e saj në bankë;
- të kryejnë klasifikimet e kredive, sipas kritereve të ndryshme individ dhe biznes (konsumatore, blerje shtëpie, afatshkurtër, afatgjatë, investime, kapital qarkullues etj);

- të shpjegojnë parimet e vendimmarrjes në financimin e klientëve;
- të përshkruajnë format e ofrimit të garancive bankare (psh financimi i import/eksporteve) dhe të marrjes së angazhimeve nga banka;
- të listojnë kriteret e leximit të regjistrit të kredisë, sipas BOA;
- të shpjegojnë rëndësinë e AML-së në kuadër të riskut reputacional të bankave;
- të përshkruajnë format e tjera të shërbimeve bankare, si; sigurimi, transferimi i informacionit financiar, shërbimet këshilluese etj;
- të analizojnë mënyrën e funksionimit të tregjeve të aksioneve dhe obligacioneve, duke përdorur shembuj konkretë;
- të shpjegojnë kuptimin, llojet dhe karakteristikat e tregjeve të letrave me vlerë;
- të përshkruajnë tiparet e tregut të këmbimit valutor, si dhe operacionet në valutë të bankave;
- të përshkruajnë mënyrat e financimit të eksport/importeve nëpërmjet një kursi më të mirë këmbimi etj;
- të renditin llojet e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe instrumentet që përdoren në to;
- të përshkruajnë strategjitë e mbrojtjes financiare dhe sigurimet;
- të vlerësojnë inovacionet e reja digjitale të ofruara nga sektori bankar;
- të menaxhojnë financat personale dhe investimet.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika bankare”, klasa 13 - 64 orë**

Tema 1	Tregjet financiare dhe produktet bankare	5 orë
Tema 2	Financimi i transaksioneve tregtare (produktet e kredisë)	9 orë
Tema 3	Parimet bazë të vendimmarrjes mbi financimet bankare	9 orë
Tema 4	Garancitë bankare	8 orë
Tema 5	Parandalimi i pastrimit të parave dhe risku reputacional	8 orë
Tema 6	Tregu i letrave me vlerë dhe kuotimi i instrumenteve financiare	6 orë
Tema 7	Veprimtaria në valutë e bankave	6 orë
Tema 8	Inovacionet teknologjike në sektorin bankar	8 orë
Tema 9	Financat personale	5 orë

3. Lënda “Ekonomi e përgjithshme” (L-17-635-23) Kl.12 – 108 orë dhe Kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë objektin e shkencës ekonomike;
- të identifikojnë problemin kryesor të ekonomisë dhe konceptin e “pamjaftueshmërisë”;
- të përshkruajnë konceptet kryesore të tregut si, kërkesa dhe oferta;
- të llogarisin elasticitetin e kërkesës dhe ofertës në lidhje me çmimin;
- të shpjegojnë ekuilibrin e tregut, si dhe rastet e ndryshimit të çmimit dhe sasisë ekuilibër;
- të identifikojnë ndryshime të ekuilibrit të tregut, si rrjedhojë e vendosjes së taksave dhe subvencioneve;
- të shpjegojnë procesin vendimmarrës për të konsumuar ose kursyer;
- të arsyetojnë sesi mund të rritet pasuria në varësi të kursimit;
- të interpretojnë dobinë si koncept ekonomik;
- të përshkruajnë ligjin e dobisë marxhinale zbritëse;
- të përcaktojnë ekuilibrin e konsumatorit;
- të argumentojnë maksimizimin e dobishmërisë;
- të dallojnë format e klasifikimit të biznesit;

- të përshkruajnë rolin ekonomik të firmave dhe format ligjore të tyre;
- të argumentojnë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit;
- të rendisin hapat për hartimin e një plan biznesi;
- të hartojnë një plan biznesi;
- të përshkruajnë prodhimin si veprimtari me qëllim fitimin;
- të përkufizojnë treguesit kryesor të prodhimit;
- të përshkruajnë tipologjitë e kostove (fikse/të ndryshueshme, e shprehur/e nënkuptuar);
- të evidentojnë dallimin ndërmjet kostove fikse dhe kostove të ndryshueshme;
- të llogarisin koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale;
- të llogarisin të ardhurat e përgjithshme, marxhinale dhe mesatare;
- të llogarisin fitimin e firmës: normal, kontabël, ekonomik;
- të përkufizojnë prodhueshmërinë e firmës;
- të identifikojnë faktorët që përcaktojnë prodhueshmërinë;
- të shpjegojnë funksionin e prodhimit;
- të evidentojnë dallimet midis periudhës afatshkurtër dhe periudhës afatgjatë;
- të shpjegojnë ligjin e të ardhurave rënëse;
- të argumentojnë veprimin e ligjit në periudhë afatshkurtër;
- të dallojnë strukturat e ndryshme të tregut dhe tiparet kryesore të tyre;
- të analizojnë efektet ekonomike të strukturave të ndryshme të tregut;
- të evidentojnë efektin rolin e rregullimit shtetëror në strukturën e tregut monopol;
- të interpretojnë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit, sipas llojeve të tyre;
- të shpjegojnë funksionin e qeverisë si arbitër, menaxher dhe lojtar në ekonominë e tregut;
- të shpjegojnë shpenzimet dhe të ardhurat në buxhetin e shtetit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl.12 - 108 orë**

Tema 1	Objekti i shkencës ekonomike	10 orë
Tema 2	Kërkesa, oferta, funksionimi i tregjeve dhe ekuilibri i tyre	12 orë
Tema 3	Konsumatorë dhe kursyes	6 orë
Tema 4	Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	12 orë
Tema 5	Fillimi një biznesi dhe financimi i tij	12 orë
Tema 6	Prodhimi, kostoja, të ardhurat dhe fitimi i firmës.	12 orë
Tema 7	Produktiviteti, funksioni i prodhimit, periudhat	8 orë
Tema 8	Strukturat e tregut, analizë krahasuese	12 orë
Tema 9	Tregjet e faktorëve të prodhimit	12 orë
Tema 10	Roli i qeverisë në ekonomi	12 orë

• **Synimet e lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, klasa 13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë ofertën monetare dhe rolin e sistemit bankar në krijimin e saj;
- të identifikojnë llojet dhe funksionet e parasë;
- të dallojnë variablat makroekonomike;
- të kryejnë dallimin dhe lidhjen midis produktit kombëtar bruto (PKB), produktit të brendshëm bruto (PBB);
- të llogaritin treguesit e koston së jetesës;
- të dallojnë metodat e llogaritjes së produktit të brendshëm bruto (PBB);
- të përshkruajnë papunësinë, llojet dhe mënyrat e matjes së saj;
- të përshkruajnë ciklin e biznesit dhe fazat e tij;
- të dallojnë kostot ekonomike e sociale që shkakton papunësia;

- të përshkruajnë konceptin e inflacionit, faktorët që ndikojnë në të, si dhe kostot që ai shkakton;
- të përshkruajnë kuptimin e kërkesës dhe ofertës agregate;
- të përshkruajnë kuptimin e politikave monetare, fiskale dhe të bëjnë dallimin ndërmjet tyre;
- të përshkruajnë instrumentet e politikës monetare dhe fiskale;
- të dallojnë përparësitë absolute dhe krahasuese;
- të shpjegojnë thelbin e bashkëpunimit ekonomik;
- të evidentojnë fazat integruese;
- të përshkruajnë kuptimin e politikave tregtare dhe rolin e organizmave ndërkombëtare të tregtisë;
- të përkufizojnë tregun valutor;
- të identifikojnë faktorët që ndikojnë kursin e këmbimit;
- të identifikojnë përfitimet e sipërmarrjes në shoqëri dhe ndikimin që sjell në zhvillimin ekonomik;
- të përcaktojnë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- të identifikojnë aftësitë sipërmarrëse për një karrierë të suksesshme;
- të evidentojnë elementët themelorë të burimeve financiare personale, si të ardhurat, kursimet dhe investimet, buxheti etj;
- të ndërtojnë një plan personal financiar;
- të përshkruajnë metodat e zhvillimit profesional dhe zhvillimit të karrierës;
- të përzgjedhin metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
- të përgatitin planin e zhvillimit të karrierës për të ardhmen e tij/saj.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Institucionet financiare dhe roli i parasë në ekonomi	10 orë
Tema 2	Treguesit kryesorë makroekonomik	10 orë
Tema 3	Politikat stabilizuese makroekonomike	10 orë
Tema 4	Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	8 orë
Tema 5	Tregtia ndërkombëtare	8 orë
Tema 6	Sipërmarrja dhe suksesi	8 orë
Tema 7	Menaxhimi i financave personale	4 orë
Tema 8	Zhvillimi profesional dhe karriera	6 orë

4. Lënda “Kontabiliteti bankar” (L-17-256-25). Kl. 13 - 96 orë

• **Synimet e lëndës “Kontabiliteti bankar”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kontabiliteti bankar”, kl.13, nxënësi duhet:

- të përshkruajnë çfarë është kontabiliteti bankar;
- të tregojnë rëndësinë e kontabilitetit bankar në funksionimin e bankave;
- të tregojnë bazën ligjore të kontabilitetit bankar;
- të tregojnë rëndësinë e respektimit të ligjeve dhe rregullave për bankat;
- të përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor në fuqi;
- të shpjegojnë çfarë është bilanci bankar dhe rëndësinë e tij;
- të shpjegojnë çfarë janë të ardhurat dhe shpenzimet bankare;
- të tregojnë llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve bankare;

- të përshkruajnë llogaritë që përdoren në kontabilitetin bankar (llogaritë e klientëve, llogaritë e bankës etj);
- të shpjegojnë mënyrën e funksionimit të llogarive tipike bankare;
- të përshkruajnë strukturën dhe organizimin e kontabilitetit sintetik dhe analitik bankar;
- të tregojnë rëndësinë e kontabilitetit sintetik dhe analitik për bankën;
- të përshkruajnë veprimet e ndryshme bankare;
- të kryejnë llogaritje të thjeshta të gjendjeve monetare, të përqindjeve, interesave, kamatvonesave, skontove, kursit të këmbimit etj;
- të shpjegojnë se si kryhet dokumentimi dhe kontabilizimi i veprimeve të çeljes së llogarive të klientëve sipas llojeve të tyre;
- të shpjegojnë funksionimin e llogarive që përdoren për kontabilizimin e veprimeve të ndryshme me llogaritë e klientëve sipas llojeve të tyre;
- të kontabilizojnë dhe dokumentojnë pagesat me para në dorë të klientëve;
- të kontabilizojnë dhe dokumentojnë arkëtimet me para në dorë nga klientët;
- të klasifikojnë llogaritë e depozitave, sipas karakteristikave të tyre;
- të llogarisin dhe kontabilizojnë interesat, komisionet dhe tatimin mbi të ardhurat nga interesat për depozitat e klientëve;
- të përshkruajnë llojet e komisioneve bankare;
- të llogarisin dhe kontabilizojnë komisionet e ndryshme bankare;
- të tregojnë llojet e ndryshme të huadhënies bankare;
- të kontabilizojnë akordimet dhe mbylljet e huadhënies të ndryshme bankare;
- të llogarisin dhe kontabilizojnë interesat e huadhënies të ndryshme bankare;
- të kontabilizojnë pagesat (këstet, shlyerjet pjesore dhe tërësore) e huadhënies bankare;
- të dallojnë llojet e monedhave dhe kartëmonedhave vendase dhe të huaja;
- të kryejnë veprime me valuta të huaja;
- të kontabilizojnë veprimet e këmbimeve valutore;
- të kryejnë veprimet midis llogarive të ndryshme të klientëve;
- të kontabilizojnë veprimet midis llogarive të ndryshme të klientëve;
- të shpjegojnë rëndësinë e raportimit dhe sistemimit të diferencave të mundshme në arkë;
- të kryejnë dhe dokumentojnë inventarizimin e arkës dhe evidentojnë diferencat;
- të kontabilizojnë saktë diferencat e evidentuara në arkë;
- të kryejnë veprimet midis terminaleve dhe ti kontabilizojnë ato;
- të kryejnë veprimet midis arkës, kasafortës dhe bankomateve dhe t'i kontabilizojnë ato;
- të tregojnë kuptimin e bankave korrespondente dhe rolin e tyre në sistemin bankar;
- të tregojnë llojet e marrëdhënies mes bankave të nivelit të dytë dhe bankave korrespondente;
- të përshkruajnë mënyrën e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës;
- të tregojnë pagesat ndërkombëtare dhe përdorimi i bankave korrespondente për kryerjen e transaksioneve ndërkombëtare;
- të tregojnë çfarë janë rezervat dhe ndihma likuide që ofron Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë;
- të përshkruajnë rregullat dhe praktikën për menaxhimin e likuiditetit ndërbankar;
- të tregojnë rastet kur dega e bankës merr fonde nga Banka e Shqipërisë dhe kontabilizimin e tyre;
- të tregojnë rastet kur dega e bankës dërgon fonde në Bankën e Shqipërisë dhe kontabilizimin e tyre;
- të tregojnë elementët e bilancit ditor të shërbimeve bankare dhe kontabilizimin e tyre;
- të tregojnë elementët e bilancit vjetor të shërbimeve bankare dhe kontabilizimin e tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kontabiliteti bankar”, kl.13 - 96 orë**

Tema 1	Kontabiliteti bankar dhe baza ligjore	6 orë
Tema 2	Bilanci bankar, të ardhurat dhe shpenzimet	6 orë
Tema 3	Struktura dhe organizimi i kontabilitetit sintetik dhe analitik bankar	4 orë
Tema 4	Llogaritje të thjeshta të veprimeve bankare	6 orë
Tema 5	Veprimet dhe kontabilizimet e çeljes së llogarive të klientëve	4 orë
Tema 6	Kontabilizimet e derdhjeve dhe pagesave me para në dorë nga arka	6 orë
Tema 7	Veprimet dhe kontabilizimet me llogaritë e depozitave	8 orë
Tema 8	Llogaritja dhe kontabilizimi i komisioneve të ndryshme bankare	8 orë
Tema 9	Regjistrimet kontabël të akordimit të llojeve të ndryshme të huadhënies	6 orë
Tema 10	Llogaritja e interesave të huadhënies dhe kontabilizimi i tyre	6 orë
Tema 11	Regjistrimet kontabël të pagesave të huadhënies	4 orë
Tema 12	Veprimet me kurset e këmbimit dhe regjistrimet kontabël përkatëse	6 orë
Tema 13	Veprimet midis llogarive të ndryshme dhe kontabilizimi i tyre	6 orë
Tema 14	Inventarizimi dhe kuadrimi ditor i arkës dhe sistemimi i diferencave	6 orë
Tema 15	Marrëdhëniet me bankat korrespondente dhe Bankën Qëndrore	8 orë
Tema 16	Hartimi i bilanceve të thjeshta ditore dhe vjetore	6 orë

5. Lënda “E drejta dhe legjislacioni” (L-17-228-25). Kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “E drejta dhe legjislacioni”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “E drejta dhe legjislacioni” në kl.13, nxënësit duhet:

- të evidentojnë dallimet ndërmjet akteve të ndryshme normative të tilla si ligjet, VKM-të, urdhëresat dhe aktet e tjera ligjore;
- të tregojnë si aplikohet legjislacioni i punësimit, shpërblimit, mbrojtjes në punë për të punësuarit në njësi të ndryshme ekonomike;
- të rendisin normativat ligjore në fuqi për sigurimet shoqërore;
- të shpjegojnë, sipas ligjit, ç’është personi fizik, personi juridik;
- të evidentojnë dallimet ndërmjet personit fizik dhe personit juridik;
- të evidentojnë dallimet ndërmjet formave të ndryshme juridike të organizimit të bizneseve;
- të shpjegojnë nocionet e përgjithshme mbi të drejtën bankare dhe karakterin e normave bankare;
- të dallojnë burimet e së drejtës bankare dhe transparencën e operacioneve bankare;
- të përshkruajnë saktë kuptimin e bankës dhe aktivitetit bankar, si dhe llojet e organizimit të bankave;
- të shpjegojnë cilat janë elementet bazë të së drejtës kontraktuale dhe kontratave bankare në veçanti;
- të përshkruajnë kuptimin e kreditit bankar si instrument i rëndësishëm në ekonomi dhe elementet përbërës të tij;
- të shpjegojnë kuptimin e sistemit të pagesave, kuadrin rregullator, rëndësinë e tij;

- të përshkruajnë llojet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si pjesë e të drejtës bankare.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “E drejta dhe legjislacioni”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi të drejtën dhe legjislacionin	6 orë
Tema 2	Legjislacioni i punësimit dhe sigurimeve shoqërore	8 orë
Tema 3	Personi juridik dhe fizik	6 orë
Tema 4	Legjislacioni për ndërmarrjet (Ligji për shoqëritë tregtare)	6 orë
Tema 5	E drejta kontraktuale dhe kontratat e shitblerjes	4 orë
Tema 6	Legjislacioni i organizimit të aktivitetit bankar dhe funksionet e bankave	8 orë
Tema 7	E drejta kontraktuale dhe kontratat bankare	8 orë
Tema 8	Legjislacioni i kreditit bankar	6 orë
Tema 9	Legjislacioni mbi sistemet e pagesave të sistemit bankar	6 orë
Tema 10	E drejta bankare dhe institucionet financiare ndërkombëtare	6 orë

6. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-24). Kl.13 – 32 orë

– **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër;
- të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale;
- të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij;
- të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin;
- të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre;
- të shpjegojnë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme;
- të përshkruajnë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore;
- të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale;
- të shpjegojnë kuptimin e cikleve të jetës së produktit dhe krijimi i mbetjeve;
- të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese;
- të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklit;
- të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimit profesionale mbi reduktimi, ripërdorimi dhe riciklim;
- të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve;
- të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklit duke përdorur teknologjinë;
- të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve;
- të shpjegojnë rëndësinë e ruajtja, menaxhimi, dhe monitorimi digjital të burimeve ujore në drejtimit profesionale përkatëse;
- të përshkruajnë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse;
- të dallojnë dhe përdorin sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit të cilësisë së ujit;
- të shpjegojnë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit;
- të përshkruajnë transportin e qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimit profesionale përkatëse;

- të dallojnë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje), si dhe përdorimin e mjeteve në veprimtari të ndryshme profesionale;
- të dallojnë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm, si dhe Intagrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik;
- të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital;
- të dallojnë praktikën etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimevet e tyre mjedisore;
- të shpjegojnë praktika dhe platforma të qëndrueshme të tregtisë elektronike, si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore;
- të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktika të ekonomisë së gjelbër dhe digjitale;
- të shpjegojnë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale;
- të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13 – 32 orë**

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime bankare”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS NË SHËRBIME BANKARE	M-17-2184-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të planifikuar, organizuar dhe dokumentuar aktivitetet e përditshme në bankë/ institucion financiar.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton rregulloren dhe procedurat e brendshme të bankës/ institucionit financiar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të zbatojë rregulloret dhe procedurat e brendshme të bankës/institucionit financiar, sipas pozicionit të punës; - të zbatojë kodin etik të veshjes dhe të paraqitjes së jashtme; - të zbatojë rregullat dhe procedurat për hyrjen në programet dhe software-t e bankës/ institucionit financiar; - të zbatojë procedurat dhe rregulloret për kryerjen e transaksioneve bankare; - të zbatojë procedurat dhe rregulloret për menaxhimin e dokumenteve; - të zbatojë procedurat dhe rregulloret për shërbimin ndaj klientëve; - të zbatojë procedurat dhe rregulloret për menaxhimin e informacionit të ndjeshëm; - të zbatojë legjislacionin në fuqi për sistemin bankar; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë zbatimit të rregullores dhe procedurave të brendshme të bankës/ institucionit financiar.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të sistemojë vendin e punës;
- të përcaktojë detyrat dhe aktivitetet ditore, sipas pozicionit të punës;
- të planifikojë objektivat e punës, për një realizim sa më efektiv të tyre;
- të planifikojë mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas funksionit;
- të përzgjedhë mjetet materialet dhe pajisjet e punës;
- të kontrollojë gatishmërinë për punë të mjeteve dhe pajisjeve, sipas manualeve përkatëse;
- të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas procedurës;
- të ndjekë procedurat për plotësimin e nevojave me mjete dhe materiale;
- të përcaktojë detyrat dhe prioritetet e shërbimeve bankare në përputhje me objektivat;
- të përzgjedhë formularët e nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve ditore;
- të zbatojë rregullat e përdorimit të pajisjeve të përbashkëta (printerat, scanera, telefona);
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë planifikimit të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës në bankë/ institucionit financiar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi organizon dhe dokumenton punën në shërbimet bankare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të përdorë mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas manualeve;
- të përdorë programet dhe software-t e bankës/ institucionit financiar, sipas manualeve;
- të menaxhojë burimet materiale të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve ditore;
- të koordinojë bashkëpunimin me eprorë dhe kolegë, sipas hierarkisë;

- të koordinojë bashkëpunimin me specialistë të tjerë, sipas nevojës;
- të dokumentojë realizimin e detyrave, sipas procedurës;
- të plotësojë formularët e nevojshëm për kryrjen e aktiviteteve ditore;
- të raportojë te eprori për realizimin e detyrave në mënyrë periodike, sipas formateve përkatëse;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë organizimit dhe dokumentimit të punës në bankë/ institucionit financiar;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë organizimit dhe dokumentimit të punës në bankë/ institucionit financiar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të planifikuar, organizuar dhe dokumentuar aktivitetet e përditshme në bankë/ institucion financiar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të planifikuar, organizuar dhe dokumentuar aktivitetet e përditshme në bankë/ institucion financiar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, fax etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.
-

2. Moduli “Komunikimi dhe etika profesionale në bankë”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI DHE ETIKA PROFESIONALE NË BANKË	M-38-2185-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të zbatuar rregullat dhe teknikat e komunikimit verbal, jo verbal, me shkrim, për të mbajtur korrespondencën zyrtare, si dhe për të prezantuar produktet dhe shërbimet bankare.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi komunikon në mënyrë verbale dhe joverbale në bankë/ institucionit financiar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të zbatojë parimet e etikës profesionale, sipas standardit; - të zbatojë rregullat e komunikimit verbal në bankë/ institucionit financiar; - të komunikojë në mënyrë të saktë dhe të qartë, sipas terminologjisë teknike ndërkombëtare; - të respektojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët; - të komunikojë në gjuhë të huaj; - të komunikojë me tonalitetin e duhur të zërit për një komunikim efektiv dhe me profesionalizëm; - të komunikojë me fjalë të thjeshta, profesionale dhe të kuptueshme; - të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të vëmendshme, gjatë komunikimit me të tretë; - të mos ndërpresë bashkëbiseduesin, gjatë bisedës; - të komunikojë duke zbatuar rregullat e komunikimit joverbal në bankë/ institucionit financiar; - të përdorë gjuhë trupi pozitive për transmetimin e mesazheve në bankë/ institucionit financiar;	

- të interpretojë sinjalet e gjuhës së trupit në komunikim;
- të mbajë kontakt me sy, gjatë bisedës si shenjë besimi dhe interesi për bashkëbiseduesin;
- të respektojë distancën fizike të përshtatshme, gjatë bisedës;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë komunikimit verbal dhe joverbal në bankë/institucion financiar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi komunikon me shkrim në bankë/ institucionit financiar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të evidentojë mjetet e korrespondencës zyrtare të shkruar në bankë/ institucionit financiar (e-mail, letra zyrtare, procedura, manuale);
- të zbatojë rregullat e komunikimit me shkrim, duke shmangur gabimet drejtshkimore, shkurtime e fjalëve etj;
- të zbatojë në mënyrë efektive rregullat e përdorimit të elementeve gjuhësore dhe të stilistikës në hartimin e letrave zyrtare ashtu edhe në komunikimin me e-mail;
- të përdorë terminologjinë teknike ndërkombëtare, gjatë komunikimit me shkrim;
- të evidentojë llojet e dokumenteve zyrtare të shkruara që përdoren në bankë/ institucionit financiar;
- të respektojë rregullat për korrespondencën zyrtare me shkrim;
- të hartojë dokumente në kompjuter për komunikimin e brendshëm (memo, qarkore, vendime);
- të hartojë dokumente në kompjuter për komunikimin e jashtëm (kërkesë informacioni, letër falenderimi, ftesa, përgjigjë) më formatet përkatëse, sipas kërkesave në situata të ndryshme;
- të sigurojë konfidencialitetin, gjatë komunikimit me shkrim dhe dokumenteve që dërgohen me e-mail;
- të ruajë integritetin e të dhënave, sipas politikave të sigurisë;
- të përdorë enkriptimin në bankë/ institucionit financiar, kur është e nevojshme;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë komunikimit me shkrim në bankë/ institucion financiar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi bashkëpunon me të tjerë, duke zbatuar parimet e punës në grup.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë teknika të prezantimit personal në mënyrë zyrtare para kolegëve, klientëve, partnerëve dhe bashkëpunëtorëve;
- të bashkëpunojë me kolegët, klientët, partnerët dhe bashkëpunëtorët;
- të zbatojë rregullat e qëndrimit në punë;
- të prezantojë institucionin e bankës/ institucionit financiar dhe produktet e saj;
- të marrë informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës, sipas nevojës;
- të prezantojë produktet e bankës/ institucionit financiar përpara klientëve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;
- të prezantojë bankën/ institucionit financiar dhe produktet e saj, duke respektuar strukturën hierarkike;
- të zbatojë parimet e punës në grup;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë bashkëpunimit me të tjerët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës dhe në bankë/institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të zbatuar rregullat dhe teknikat e komunikimit verbal, jo verbal, me shkrim, me klientët dhe bashkëpunëtorët, për të mbajtur korrespondencën zyrtare, si dhe për të prezantuar produktet dhe shërbimet bankare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të zbatuar rregullat dhe teknikat e komunikimit verbal, jo verbal, me shkrim, me klientët dhe bashkëpunëtorët, për të mbajtur korrespondencën zyrtare, si dhe për të prezantuar produktet dhe shërbimet bankare.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

	kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike. - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj. - Mjete kancelarie. - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

3. Moduli “Çelja dhe mbyllja e arkës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ÇELJA DHE MBYLLJA E ARKËS	M-17-2186-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar proceset e çeljes dhe mbylljes së arkës, si dhe verifikimin e gjendjes monetare, gjatë operacioneve të përditshme.	
Kohëzgjatja e modulit	78 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton procedurat e sigurisë për çeljen e arkës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të vlerësojë riskun e mundshëm, gjatë procesit të çeljes së arkës; - të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për çeljen e arkës; - të përzgjedhë dokumentacionin e nevojshëm për çeljen e arkës; - të përzgjedhë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve ditore; - të menaxhojë burimet materiale dhe mjetet e nevojshme për çeljen e arkës; - të zbatojë procedurat dhe udhëzuesit për përdorimin dhe ruajtjen e kredencialeve për hyrjen dhe daljen nga sistemi informatik bankar, sipas procedurave; - të përdorë TIK në çelje të sistemeve bankare, sipas procedurave; - të përdorë kredencialet për hyrjen në sistemin qendror bankar, sipas procedurave; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë zbatimit të procedurave të sigurisë për çeljen e arkës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi verifikon e gjendjen monetare.	

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përcaktojë llojet e monedhave dhe kartëmonedhave vendase dhe të huaja, si dhe dallimin midis tyre;
- të marrë në dorëzim dokumentet financiare, regjistrat e arkës, dhe raportet e mëparshme të gjendjes monetare ;
- të respektojë procedurat përkatëse për marrjen në dorëzim cash-in e ditës;
- të realizojë transferimin e fondeve ndërmjet kasafortave (qendrore-personale), sipas procedurave;
- të verifikojë me përpikmëri cash-in e marrë nga kasaforta qendrore;
- të verifikojë monedhat dhe kartëmonedhat, sipas elementëve të sigurisë;
- të raportojë sipas procedurave rastet e mungesave të elementëve të sigurisë të monedhave dhe kartëmonedhave;
- të përdorë pajisjet për verifikimin e cash-it, sipas manualeve;
- të identifikojë rastet e mospërputhjeve të shumave fizike me dokumentacionin përkatës;
- të raportojë sipas procedurave mospërputhjet e shumave fizike me dokumentacionin përkatës;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë verifikimit të gjendjes monetare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi dokumenton çeljen e arkës.***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për të dokumentuar procesin e çeljes së arkës;
- të përzgjedhë formularët dhe regjistrat e nevojshëm (fizikë dhe dixhitalë) për të dokumentuar çeljen e arkës;
- të regjistrojë datën dhe orën e çeljes së arkës si pjesë të dokumentacionit;
- të dokumentojë shumën e gjendjeve monetare të marra në dorëzim, sipas procedurave dhe manualeve;
- të dokumentojë sipas procedurave dhe manualeve rastet e mungesave të elementëve të sigurisë të monedhave dhe kartëmonedhave;
- të dokumentojë sipas procedurave dhe manualeve mospërputhjet e shumave fizike me dokumentacionin

- përkatës;
- të regjistrojë hyrjen e cash-it në system, sipas procedurave përkatëse;
- të sigurojë nëshkrimin e dokumentacionit (të plotësuar prej tij/saj) nga supervizori përkatës, sipas procedurave;
- të menaxhojë dokumentacionin e plotësuar, gjatë procesit të çeljes së arkës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë çeljes së arkës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi kryen përgatitjet për mbylljen e arkës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për të dokumentuar procesin e mbylljes së arkës;
- të përzgjedhë formularët dhe regjistrat e nevojshëm (fizikë dhe dixhitalë) për të dokumentuar mbylljen e arkës;
- të sistemojë cash-in e ditës të depozituar në arkë;
- të përdorë pajisjet për verifikimin e cash-it, sipas manualeve;
- të kuadrojë gjendjen monetare në sistem me atë fizike, sipas procedurës përkatëse;
- të inventarizojë mjetet monetare në arkë dhe në kasafortën personale;
- të identifikojë diferencat e mundshme të gjendjes në sistem me atë fizike;
- të kontrollojë që çdo transaksion që është kryer gjatë ditës (depozita, tërheqje etj.) është regjistruar dhe i dokumentuar saktë;
- të identifikojë transaksionet e bëra gjatë ditës që kanë mospërputhje ose gabim në regjistrime;
- të raportojë diferencat e mundshme të gjendjes në sistem me atë fizike, sipas procedurave;
- të sistemojë transaksionet e bëra gjatë ditës që kanë mospërputhje ose gabim në regjistrime, sipas procedurave dhe manualeve;
- të kontabilizojë saktë diferencat e mundshme të gjendjes në sistem me atë fizike;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;

- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë parapërgatitjes për mbylljen e arkës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi kryen mbylljen e arkës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të raportojë sistemimin e diferencave të mundshme në arkë, sipas procedurës dhe formateve;
- të plotësojë saktë dokumentacionin fizik dhe digjital për mbylljen e arkës;
- të kryejë daljen e cash-it dhe mbylljen e ditës në sistem, sipas procedurave përkatëse;
- të dorëzojë tepricën monetare ditore, sipas procedurës;
- të realizojë transferimin e fondeve ndërmjet kasafortave (personale - qendrore), sipas procedurave;
- të sigurojë nëshkrimin e dokumentacionit (të plotësuar prej tij/saj) nga supervizori përkatës sipas procedurave;
- të menaxhojë dokumentacionin e plotësuar, gjatë procesit të mbylljes së arkës;
- të dorëzojë dokumentacionin e veprimeve ditore, sipas procedurës;
- të dorëzojë pajisjet, materialet dhe elementët e sigurisë, sipas procedurës;
- të raportojë problematikat në lidhje me çeljen dhe mbylljen e ditës, sipas procedurës dhe formateve;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë mbylljes së arkës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të realizuar proceset e çeljes dhe mbylljes së arkës, si dhe verifikimin e gjendjes monetare, gjatë operacioneve të përditshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të realizuar

	proceset e çeljes dhe mbylljes së arkës, si dhe verifikimin e gjendjes monetare, gjatë operacioneve të përditshme. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike. - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj. - Mjete kancelarie. - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

4. Moduli “Përpunimi i Cash-it”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I CASH-IT	M-17-2187-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit, për të kryer procedurat e sistemimit të cash-it para dorëzimit në kasafortën qendrore, procedurat për mbushjen/zbrazjen e ATM-ve, si dhe regjistrin hyrjet dhe daljet fizike të cash-it nga arka në sistem.	
Kohëzgjatja e modulit	78 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi identifikon elementet e sigurisë së Cash-it. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të verifikojë autenticitetin e bankënotave nëpërmjet pajisjeve të specializuara; - të përdorë makineritë për numërimin e parave; - të identifikojë monedhat dhe bankënotat e dëmtuara; - të përdorë kasat e bliduara dhe sistemet e sigurisë për mbrojtjen fizike të parave; - të zbatojë rregullat dhe protokollat për kontrollin e aksesit në hapësirat ku përpunohet cash-i; - të monitorojë të gjitha veprimet që lidhen me cash-in (depozitimi, tërheqje, transferimi) për të mundur gjurmimin e çdo gabimi apo shkelje të mundshme; - të dorëzojë cash-in në kompanitë e specializuara për një transport të sigurt; - të gjurmojë cash-in nëpërmjet teknologjisë në kohë reale (GPS, sistemet e monitorimit); - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë identifikimit të elementeve të sigurisë së Cash-it. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen procedurat e sistemimit të cash-it, para dorëzimit në kasafortën qendrore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të kryejë kontrollin vizual dhe mekanik të bankënotave dhe monedhave;
- të veçojë bankënotat e dëmtuara ose të papërdorshme dhe t'i dërgoj ato për riparim apo zëvendësim;
- të kryejë numërimin automatik të parave nëpërmjet makinave përkatëse;
- të klasifikojë bankënotat dhe monedhat, sipas kategorive të ndryshme dhe konsumimit të tyre;
- të plotësojë formularët e depozitimit të cash-it në kasafortën qendrore;
- të plotësojë dokumentet shoqëruese të transferimit të cash-it në kasafortën qendrore;
- të transportojë cash-in nga sporteli në kasafortën qendrore, duke përdorur arkat e blinduara;
- të verifikojë sasinë e cash-it para vendosjes në kasafortë, për të siguruar që nuk ka ndoshur asnjë gabim gjatë transportit;
- të ruajë cash-in në mënyrë të sigurt (kasa të blinduara, sisteme të avancuara të sigurisë për të parandaluar aksesin e paautorizuar);
- të kryejë regjistrimin e depozitës në sistemin e menaxhimit të cash-it;
- të përgatitë cash-in që është depozituar në kasafortën qendrore nëse është i destinuar për përdorim të mëtejshëm (përdorim në transaksione të ardhshme ose transferim në degët e tjera);
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë procedurave të sistemimit të cash-it, para dorëzimit në kasafortën qendrore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen sortimin e valutave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të numërojë bankënotat dhe monedhat, sipas prerjeve të

- ndryshme;
- të përgatitë pajisjet për sortimin e valutave (makinat për numërimin e parave dhe makinat për klasifikimin e bankënotave), sipas kushteve;
- të përgatitë grupet e bankënotave, sipas prerjeve të ndryshme;
- të klasifikojë bankënotat (bankënota të reja dhe të përdorura), sipas statusit të tyre;
- të grupojë bankënotat e dëmtuara dhe të vjetra, për riparim ose për zëvendësim;
- të regjistrojë në raportet përkatëse sasinë dhe statusin e çdo grupi të valutës;
- të vendosë valutat e sortuara në seksione të ndryshme të kasafortës, për t'u aksesuar dhe përdorur lehtësisht, sipas kërkesave;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë sortimit të valutave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përdor makineritë detektuese dhe të numërimit të cash-it.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përshkruajë funksionimin e makinerive detektuese për cash-in e falsifikuar;
- të kontrollojë vërtetësinë e bankënotave, nëpërmjet dritës ultra violetë;
- të kontrollojë vërtetësinë e bankënotave, nëpërmjet magnetizimit;
- të kontrollojë elementet e sigurisë së dukshme dhe të ndryshueshme, nëpërmjet kamerave dhe sensorëve;
- të kontrollojë vërtetësinë e bankënotave, nëpërmjet sensorit të dendësisë dhe strukturës;
- të kontrollojë vërtetësinë e bankënotave, nëpërmjet hologrameve dhe mikroskrimeve;
- të përdorë makineritë me sensorë optikë për të lexuar dhe analizuar karakteristikat e bankënotave;
- të përdorë makineritë për kontrollin e gjendjes dhe cilësisë së bankënotave;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë përdorimit të makinerive

- detektuese dhe të numërimit të cash-it;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përdorimit të makinerive detektuese dhe të numërimit të cash-it.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi regjistron hyrjet dhe daljet fizike të cash-it nga arka në sistem.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të regjistrojë depozitat e cash-it në formularët e depozitimit të cash-it;
- të plotësojë formularët e depozitimit dhe urdhërpagesat për të regjistruar hyrjet e cash-it;
- të regjistrojë në sistemin e kontabilitetit të bankës/institucionit financiar, pasi është vërtetuar saktësia e depozitës;
- të kontrollojë përditësimin e balancës së arkës në fund të çdo depozitimi;
- të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e cash-it në arka për të siguruar që nuk do të ketë mungesë të parave;
- të regjistrojë daljet e cash-it nga arka në dokumentet përkatëse;
- të plotësojë faturat dhe raportet e pagesave për të regjistruar daljet e cash-it;
- të regjistrojë në sistemin e kontabilitetit të bankës/institucionit financiar, pasi është vërtetuar saktësia e daljes së cash-it;
- të kontrollojë përditësimin e balancës së arkës në fund të çdo tërheqje të cash-it;
- të plotësojë raportet ditore ose javore për të monitoruar dhe kontrolluar fluksin e cash-it;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë regjistrimit të hyrjeve dhe daljeve fizike të cash-it nga arka në sistem.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi kryen procedurat për mbushjen/zbrazjen e ATM-së.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përgatitë ATM-në për mbushjen e saj (përzgjedhja e parave);
- të verifikojë sasinë e denominimit (cash-i i ndarë sipas prerjeve dhe të kontrolluara për mundësinë e dëmtimit);
- të përgatitë dokumentet mbështetëse të mbushjes së ATM-së (formularët e mbushjes, listën e cash-it dhe shënimet për çdo lëvizje të tij);
- të verifikojë autorizimin e nevojshëm për mbushjen e ATM-së;
- të verifikojë sasinë e parave para se të vendosen në ATM;
- të testojë funksionimin e ATM-së pas mbushjes;
- të regjistrojë sasinë e cash-it që do të vendosen në ATM, pas verifikimit në sistem;
- të verifikojë autorizimin e nevojshëm për zbrazjen e ATM-së;
- të përgatitë dokumentet mbështetëse të zbrazjes së ATM-së (formularët e zbrazjes, listën e cash-it dhe shënimet për çdo lëvizje të cash-it);
- të kryejë procesin fizik të zbrazjes së ATM-së;
- të regjistrojë lëvizjet e kryera në sistem;
- të verifikojë përputhshmërinë e sasisë fizike të cash-it të tërhequra nga ATM-ja, me sasinë e cash-it që rezulton në sistem;
- të transportojë cash-in e zbrazur nga ATM-ja;
- të dërgojë cash-in e tërhequr në kasafortë si depozitë e bankës/ institucionit financiar;
- të përgatitë një raport të plotë të zbrazjes së ATM-së;
- të përditësojë balancën e cash-it;
- të regjistrojë sasinë e cash-it të tërhequr;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së procedurave për mbushjen/zbrazjen e ATM-së.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi plotëson dokumentet shoqërues për transferimin e cash-it.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të plotësojë formularin e transferimit të cash-it;

- të plotësojë formularin e transportit të cash-it, i cili përmban informacionin mbi dërguesin dhe marrësin e cash-it, si dhe sasinë e cash-it që po transferohen;
- të regjistrojë në faturën e transferimit të cash-it e cila përmban informacionin e sasisë së cash-it që transferohen, origjinën e këtyre fondeve, si dhe qëllimin e transferimit;
- të përgatitë protokollin e sigurisë, gjatë transportimit të cash-it për të parandaluar vjedhjen ose humbjen e cash-it;
- të plotësojë formularët e dërgesës dhe marrjes së cash-it;
- të hartojë raportin e auditimit të cash-it për lëvizjet e tij, si dhe të gjithë aktivitetet që përfshijnë cash fizik;
- të depozitojë të gjitha dokumentet shoqëruese për ruajtjen e tyre në dosjet e bankës/ institucionit financiar.
- të përdorë teknologjinë për monitorimin e transferimit të cash-it në kohë reale, përfshirë edhe sistemet e sigurisë;
- të përdorë sisteme të automatizuara për të regjistruar dhe ruajtur dokumentacionin;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë plotësimit të dokumenteve shoqërues për transferimin e cash-it.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare. - Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer procedurat e sistemimit të cash-it para dorëzimit në kasafortën qendrore, procedurat për mbushjen/zbrazjen e ATM-ve, si dhe regjistrin hyrjet dhe daljet fizike të cash-it nga arka në sistem. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer procedurat e sistemimit të cash-it para dorëzimit në kasafortën qendrore, procedurat për mbushjen/zbrazjen e ATM-ve, si dhe regjistrin hyrjet dhe daljet fizike të cash-it nga arka në sistem. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike.

-
- Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.
-

5. Moduli “Veprimet në shërbime bankare”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VEPRIMET NË SHËRBIME BANKARE	M-17-2188-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimet me llogaritë e kursimit dhe depozitat, verifikimin e dokumentacionit të aplikimit për kredi, kontrollimin e aftësisë paguese të kredimarrësit, veprimet pas miratimit të kredisë, kthime tërësore ose pjesore të kredisë, si dhe për të kryer veprime me kartat e debitit dhe kreditit.	
Kohëzgjatja e modulit	78 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen veprimet e çeljes së llogarive të kursimit dhe depozitave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të identifikojë klientin gjatë kryerjes së veprimeve të çeljes së llogarive të kursimit dhe depozitave për llogaritë individ dhe biznes, - të amendojë të dhënat në sistem me dokumentin e vlefshëm të identifikimit; - të hapë llogaritë e depozitës në sistem, duke plotësuar sipas kërkesës së klientit kushtin “dhe”/”ose” për të drejtat mbi llogarinë e depozitës dhe veprimet që titullarët do të kryejnë në vazhdimësi; - të depozitojë nënshkrimin në kartën e specimenteve për titullarin/titullarët e depozitës; - të përditësojë dhe bashkangjisë skanimin e nënshkrimit në sistem; - të pajisë klientin me kredencialet e NRP-së (numri rendor personal) dhe numër llogarie/depozitë për kontrollin e llogarisë nga aplikacioni i bankës/ institucionit financiar; - të arkëtojë saktë në sistem shumën që klienti do të derdhë në llogarinë e depozitës, sipas prerjeve; - të regjistrojë saktë në sistem shumën që klienti do të derdhë në llogarinë e depozitës, sipas prerjeve;	

- të regjistrojë saktë shumën e tërhequr në llogarinë e depozitës/statement, sipas urdhërit të klientit;
- të pasqyrojë saktë në librezë/statement interesat që do të maturohen në mbarim të afatit të depozitës;
- të pasqyrojë saktë komisionet ose penalitetet në rastin e “thyerjes” (tërheqjeve para maturimit të interesave) së afatit të depozitës;
- të informojë klientin mbi veprimet që kryhen në ATM për depozitimet cash/in, cash/out duke përdorur kartën e debitit/kreditit të lidhur me llogarinë rrjedhëse;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve të çeljes së llogarive të kursimit dhe depozitave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen veprimet me llogaritë e kursimit dhe depozitat.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të llogaritë saktë interesat e maturuara, në varësi të llojit dhe afatit të depozitës;
- të llogaritë TAP-in në përputhje me ligjin mbi tatimin në burim;
- të llogaritë shumën e interesit që do të përfitojë klienti, duke zbritur nga interesat e maturuara, TAP-in dhe komisionet;
- të pasqyrojë shumën e interesave të maturuara në llogarinë e depozitës së klientit, në rastin kur interesat kapitalizohen;
- të kryejë xhirimin e interesave neto në llogarinë e bashkëlidhur me depozitën;
- të pasqyrojë komisionin e bankës/ institucionit financiar për depozitën, sipas afateve;
- të përcaktojë normën e interesit që do të aplikohet në bazë të buletinit të, sipas kushteve të punës së bankës/ institucionit financiar;
- të informojë klientin rreth procedurave dhe penaliteteve që aplikohen, bazuar në buletinin e publikuar, sipas kushteve të bankës/ institucionit financiar;
- të informojë klientin rreth procedurave dhe penaliteteve që aplikohen në rastin e thyerjes së afatit të depozitës;
- të llogaritë saktë interesin për kohën e qëndrimit të depozitës, deri në ditën që bëhet tërheqja e saj nga klienti;

- të llogaritë penalitetin në rastin e thyerjes së afatit të depozitës;
- të llogaritë saktë interesin neto që do të përfitojë klienti, duke bërë zbritjet e nevojshme;
- të njoftojë klientin mbi ndryshimet e gjendjes së llogarisë;
- të njoftojë klientin për maturimin e depozitës, si dhe zgjedhjen e kushtit për rinovimin automatik të saj;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve me llogaritë e kursimit dhe depozitat.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi verifikon dokumentacionin e aplikimit për kredi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të verifikojë plotësimin e të gjitha kërkesave për dokumentacionin që kërkon banka, për rastet e kredidhënies për individë;
- të verifikojë plotësimin e të gjitha kërkesave për dokumentacion që kërkon banka, për rastet e kredidhënies për biznese;
- të përdorë teknika komunikimi të përshtatshme për marrjen e informacionit të nevojshëm nga klientët që aplikojnë për kredi;
- të zbatojë politikat e bankës/ institucionit financiar në sektorin e kredisë;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë verifikimit të dokumentacionit të aplikimit për kredi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kontrollon aftësinë paguese të kredimarrësit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të llogaritë aftësinë paguese të kredimarrësit, duke u bazuar në të ardhurat e tyre;
- të përdorë analizën SWOT në lidhje me situatën financiare të klientit;
- të verifikojë historikun e raporteve të klientit me bankën/ institucionin financiar ku aplikohet për kredi dhe me

- bankat e tjera;
- të shqyrtojë qëllimin e përdorimit të kredisë dhe planin përkatës të investimit;
- të shqyrtojë planin e biznesit të paraqitur nga klienti;
- të shqyrtojë garancinë e paraqitur nga klienti për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në rast të mungesës së aftësisë paguese të tij, si dhe deklaratën financiare të garantuesit (kur ka një të tillë);
- të hartojë grafikun e shlyerjes së kredisë në bazë të afatit të shlyerjes dhe formulës përkatëse;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kontrollimit të aftësisë paguese të kredimarrësit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen veprimet pas miratimit të kredisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të njoftojë klientin për miratimin e kredisë (kur vendimi merret nga këshilli drejtues i bankës/ institucionit financiar);
- të kërkojë që klienti të lexojë me vëmendje marrëveshjen për kreditë, si dhe t'ia nënshkruajë atë;
- të informojë qartë klientin në lidhje me shlyerjet, kamatvonesat dhe penalitetet e tjera në rast mospagimi në afatin e duhur;
- të informojë qartë klientin në lidhje me ndryshimin e këstit të shlyerjes së kredisë për efekt të EURIBOR;
- të printojë planin e shlyerjes së kredisë për një periudhë të paktën 1-vjeçare, si dhe t'ia dorëzojë atë klientit;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve pas miratimit të kredisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi kryen veprimet që lidhen me kthimin tërësor ose pjesor të kredisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;

- të hartojë planet e shlyerjes së kredisë;
- të kontrollojë afatet e shlyerjes tërësore ose pjesore të kredisë, sipas klientëve;
- të verifikojë shlyerjen e kësteve të kredisë;
- të hartojë njoftimet për shlyerjen e kredisë;
- të evidentojë kreditë të cilave iu ka kaluar afati i shlyerjes;
- të grupojë kreditë, sipas rrezikshmërisë së shlyerjes së tyre;
- të dokumentojë shlyerjen e kësteve të kredisë;
- të kryejë procedurat e përfundimit të marrëdhënies së kredisë me klientin, në rastin kur kredia shlyhet në afatin e përcaktuar dhe pa probleme;
- të ndjekë procedurat në rastin e mos shlyerjes në afat të kredisë;
- të llogaritë provigjionet për kreditë me probleme, sipas grupeve përkatëse;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve që lidhen me kthimin tërësor ose pjesor të kredisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi pranon çeket nga klienti i bankës, banka korrespondente dhe qendra e kleringut.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të verifikojë plotësimin e elementeve formale të çekut;
- të pranojë çeqe për arkëtim nga klienti i bankës/ institucionit financiar, banka korrespondente dhe qendra e kleringut, me të drejtën e disponimit;
- të verifikojë gjendjen e llogarisë së klientit pagues;
- të aprovojë pagesën e çekut, në rastin e aftësisë paguese;
- të pranojë çeket për arkëtim nga klienti i bankës/ institucionit financiar, me të drejtën e rezervës për arkëtim;
- të dërgojë çekun te banka/ institucionit financiar korrespondente;
- të dërgojë çekun nëpërmjet qendrës së kleringut (clearing-ut);
- të përpunojë njoftimin që vjen nga banka korrespondente;
- të kthejë çeket e pa arkëtuara te klienti, tek banka korrespondente ose te qendra e kleringut;
- të përgatitë njoftimin për klientin për mospagimin e një

- çeku për paaftësi paguese;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë pranimit të çqeve nga klienti i bankës, banka korrespondente dhe qendra e kleringut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 8 Nxënësi kryen veprime me kartat e debitit dhe kreditit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të presë dhe informojë klientin;
- të kërkojë në sistem llogarinë dhe kodin e klientit për të verifikuar në se është klient i bankës/ institucionit financiar ose jo;
- të verifikojë plotësimin e formularit të aplikimit për kartë debiti, kartë krediti ose kartë krediti me vlerë të limituar, nga ana e klientit dhe ta ndihmojë atë në se është e nevojshme;
- të dërgojë njoftimin në institutin përkatës të kreditit;
- të çelë një llogari depozite garancie për kartën e kreditit me vlerë të limituar;
- të arkëtojë dhe bllokojë shumën e kërkuar gjendje në depozitën garanci, sipas kërkesave të bankës;
- të çelë llogari rrjedhëse të bashkëlidhur me llogarinë e kartës së kreditit;
- të marrë njoftimin nga instituti përkatës i kreditit dhe njoftojë klientin për mbërritjen e kartës;
- t'i dorëzojë klientit kartën e kreditit dhe zarfin e PIN-it;
- të marrë njoftimin nga instituti përkatës i kreditit për pagesa, të kryera nga klienti, me kartën e tij;
- të pakësojë llogarinë e klientit në favor të institutit përkatës të kreditit dhe dërgojë njoftimin klientit për pakësimin e llogarisë së tij;
- të përgatitë dhe dërgojë njoftimin klientit për plotësimin e shumës së paguar, në se nuk është gjendje në llogari;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve me kartat e debitit dhe kreditit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionale pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare. - Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të për të kryer veprimet me llogaritë e kursimit dhe depozitat, verifikimin e dokumentacionit të aplikimit për kredi, kontrollimin e aftësisë paguese të kredimarrësit, veprimet pas miratimit të kredisë, kthime tërësore ose pjesore të kredisë, si dhe për të kryer veprime me kartat e debitit dhe kreditit. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të për të kryer veprimet me llogaritë e kursimit dhe depozitat, verifikimin e dokumentacionit të aplikimit për kredi, kontrollimin e aftësisë paguese të kredimarrësit, veprimet pas miratimit të kredisë, kthime tërësore ose pjesore të kredisë, si dhe për të kryer veprime me kartat e debitit dhe kreditit. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike. - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj. - Mjete kancelarie. - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

5. Moduli “Veprimet në shërbime bankare”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VEPRIMET NË SHËRBIMET BANKARE	M-17-2188-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprime bankare, transaksione me kurset e këmbimit, interesa debitore dhe kreditore, veprime me fondet e investimit, bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të shtetit shqiptar.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12-të, të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen veprime me kurset e këmbimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të informojë qartë klientin mbi kurset e këmbimit të ditës të aplikuara nga banka; - të llogarisë saktë shumën e transaksionit të këmbimit valutor dhe komisionet përkatëse të këtij shërbimi; - të regjistrojë saktë transaksionin e këmbimit valutor midis llogarive të klientit; - të marrë në dorëzim dhe kryejë kontrollin e saktë dhe verifikimin e valutave të dorëzuara në arkë nga klienti (veprime me cash); - të regjistrojë saktë trasaksionin për këmbimin valutor në cash; - të kontabilizojë saktë transaksionin e këmbimit valutor; - të marrë nënshkrimin e klientit për veprimin e kryer; - t'i dorëzojë klientit shumën e konvertuar sipas valutës përkatëse; - t'i dorëzojë klientit kopjen e dokumentit për veprimin e kryer në bankë/ institucionin financiar me nënshkrimin e punonjësit të bankës/ institucionit financiar; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve me kurset e këmbimit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi informon klientin për interesat debitore dhe kreditore për bankën/ institucionin financiar, si dhe komisione të ndryshme për mbajtjen e llogarive.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të informojë qartë klientin për normën e interesit, për llogaritë me tepricë të vazhdueshme debitore;
- të informojë qartë klientin për mënyrën e llogaritjes së interesit, për llogaritë me tepricë të vazhdueshme debitore;
- të informojë qartë klientin për normën e interesit për llogaritë me tepricë të vazhdueshme kreditore.
- të informojë qartë klientin për mënyrën e llogaritjes së interesit, për llogaritë me tepricë të vazhdueshme kreditore.
- të informojë qartë klientin, për interesat aktive e pasive apo të alternuara të pasqyruara në llogaritë e tij.
- të informojë qartë klientin për komisionet bankare të pasqyruara në llogaritë e tij;
- t'i dorëzojë klientit njoftim debitimet/kreditimet e kryera në llogaritë e tij.
- t'i dorëzojë klientit lëvizjet e llogarive të tij bankare;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë informimit të klientit për interesat debitore dhe kreditore për bankën/ institucionin financiar, si dhe komisione të ndryshme për mbajtjen e llogarive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen veprimet për fondin e investimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të informojë qartë klientin për mënyrën si funksionon fondi i investimit;
- të llogarisë saktë fitimin apo humbjen e mundshme që

mund të realizojë klienti për blerjen e kuotave të fondit të investimit;

- të informojë qartë klientin mbi mënyrën si ruhen dhe depozitohen fondet në fond;
- të informojë qartë klientin për mënyrën si funksionon tërheqja nga fondi;
- të informojë qartë klientin për komisionet që aplikohen dhe tatimin mbi fitimin që realizohet;
- të kryejë urdhër blerjen dhe urdhër pagesën drejt fondit;
- t'i dorëzojë klientit kopjen e dokumentit për veprimin e kryer në bankë/ institucion financiar me nënshkrimin e punonjësit të bankës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve për fondin e investimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigjë me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi kryen veprimet me bonot e thesarit ose investime në letra me vlerë të shtetit shqiptar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të informojë qartë klientin për normën e interesit të aplikuar të dalë nga ankandi i fundit;
- të informojë qartë klientin mbi të dhënat e ankandit në fuqi, datën e zhvillimit dhe emetimit të rezultatit;
- të çelë llogarinë e ngurtësimit që sipas procedurave për bonot e thesarit/ letrat me vlerë të Shtetit Shqiptar;
- t'i dorëzojë klientit dokumentin e aplikimit me firmën e përfaqësuesve të bankës/ institucionit financiar;
- të informojë klientin për normën e interesit që është aplikuar, komisionin dhe datën e maturimit të vlerës së investuar;
- të informojë klientin mbi tatimin mbi fitimin e aplikuar;
- t'i dorëzojë klientit certifikatën e investimit pas daljes së rezultatit të ankandit;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve me bonot e thesarit ose investime në letra me vlerë të shtetit shqiptar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigjë me gojë dhe shkrim.

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit
dhe vlerësimin e
nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer veprimet bankare, transaksionet me kurset e këmbimit, interesat debitore dhe kreditore, veprimet me fondet e investimit, bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të shtetit shqiptar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer veprimet bankare, transaksionet me kurset e këmbimit, interesat debitore dhe kreditore, veprimet me fondet e investimit, bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të shtetit shqiptar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.
-

6. Moduli “Veprimet në shërbime bankare digjitale”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VEPRIMET NË SHËRBIME BANKARE DIGJITALE	M-17-2189-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të shqyrtuar dokumentacionin, kushtet e aplikimit për shërbimet online, si dhe zbaton rregullat për sigurinë në shërbimet digjitale bankare.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12-të, të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi shqyrton dokumentacionin, kushtet e aplikimit për kartë debiti/krediti. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të identifikojë klientin përmes mjetit të identifikimit (ID ose Pasaportë); - të verifikojë në sistem nëse është klient i ri apo ekzistues; - të procesojë në sistem aplikimin për kartë debiti, duke ju përmbajtur kërkesave të klientit mbi monedhën (Lek, Eur), llojin e kartës (Visa/Master); - të shpjegojë përdorimin dhe funksionalitetet e kartës së debitit; - të shpjegojë avantazhet e përdorimit të kartës së debitit në krahasim me përdorimin e cash; - të kontrollojë nëse klienti plotëson kushtet, sipas procedurës së bankës/ institucionit financiar për t'u pajisur me kartë krediti; - të plotësojë formularin e aplikimit të kartës së kreditit; - të procesojë në sistem aplikimin për kartë krediti, duke ju përmbajtur kërkesave të klientit (monedha, lloji i kartës), por edhe procedurës së bankës për limitin e saj; - të shpjegojë përdorimin dhe funksionalitetet e kartës së kreditit; - të shpjegojë mënyrën e pagesës së kartës së kreditit, si dhe kthimin e detyrimit të krijuar ndaj bankës/ institucionit financiar; - të dorëzojë kartën e debitit/kreditit klientit (kur të	

- mbërrijë në bankë, pas prodhimit të saj);
- të ndihmojë klientin për aktivizimin e saj;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, kushtet e aplikimit për kartë debiti/krediti.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi shqyrton dokumentacionin, kushtet e aplikimit për shërbimet online e-banking/m-banking.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të identifikojë klientin përmes mjetit të identifikimit (ID ose Pasaportë);
- të verifikojë në sistem nëse është klient i ri apo ekzistues;
- të procesojë në sistem aplikimin për platformat online;
- të shpjegojë mënyrën e funksionimit të platformave online të bankës/ institucionit financiar dhe shërbimeve që mund të kryejë me to;
- të plotësojë formularin e aplikimit të platformave online;
- të procesojë në sistem formularin e aplikimit të platformave online;
- të dorëzojë te klienti kredencialet (username dhe fjalëkalim) e gjeneruara nga sistemi me të cilat klienti do të aksesojë llogarinë e tij online;
- të mbështetë klientin për të aksesuar platformën online të bankës/ institucionit financiar në versionin desktop;
- t'i shpjegojë klientit mënyrën e përdorimit të saj;
- të mbështetë klientin për të shkarkuar në celularin e tij aplikacionin mobile banking;
- t'i shpjegojë klientit mënyrën e përdorimit të tij;
- të shpjegojë metodat e autentifikimit apo elementet e sigurisë që përdorin platformat e bankës/ institucionit financiar, si dhe funksionimin e tyre;
- t'i shpjegojë klientit për përfitimet e përdorimit të platformave online dhe mobile si (aksesi në shërbime, ulja e kostove dhe rritja e efikasitetit);
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, kushtet e aplikimit për shërbimet online e-banking/m-banking.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi zbaton rregulloren për sigurinë në shërbimet digjitale bankare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të bankës/ institucionit financiar, Bankës së Shqipërisë ose autoriteteve të tjera mbi shërbimet digjitale;
- të shpjegojë sigurinë e platformave online që përdorin bankat;
- të shpjegojë metodat e autentifikimit (fjalëkalim, mTAN, TOKEN, KTMS etj);
- t'i shpjegojë klientit se si të mbrohet nga mashtrimet (phishing) apo sulmet kibernetike, gjatë përdorimit të platformave online (të mos hapë e-maile të dyshimta, mos klikojë mbi link të panjohur, të mos ndajë informacionin personal me persona të paautorizuar);
- të raportojë nëse shikon diçka të dyshimtë, gjatë përdorimit të platformave online;
- të shpjegojë rrjetet e rekomandueshme përmes të cilave duhet të përdorë shërbimet bankare digjitale;
- të shmangë përdorimin e rrjeteve publike Wi-Fi;
- të zbatojë procedurat e raportimit të transaksioneve të dyshimta (të realizuara me kartë ose transfertë), përmes platformave digjitale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë zbatimit të rregullores për sigurinë në shërbimet digjitale bankare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigjë me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të shqyrtuar dokumentacionin, kushtet e aplikimit për shërbimet online, si dhe zbaton rregullat për sigurinë në shërbimet digjitale bankare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të shqyrtuar dokumentacionin, kushtet e aplikimit për shërbimet online, si dhe zbaton rregullat për sigurinë në shërbimet digjitale bankare.

	- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike. - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj. - Mjete kancelarie. - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

7. “Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE	M-17-1984-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike, në lidhje me koncepte të rëndësishme si, komunikimi me eprorët dhe kolegët, identifikimi i problematikave në vendin e punës, si dhe zgjidhja e problemeve profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12-të, të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi komunikon me eprorët dhe kolegët. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të identifikojë aftësitë e duhura, si çelësi i komunikimit të efektshëm në ndërmarrje; - të ndërtojë kanalet e komunikimit; - të adresojë drejt dhe saktë problematikën; - të zhvillojë aftësinë e përshtatjes, gjatë komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm; - të përcaktojë aftësitë që influencojnë sjelljen e individit në marrëdhëniet e punës; - të zbatojë rregullat e komunikimit me eprorët, duke përdorur inteligjencën emocionale; - të zbatojë rregullat e komunikimit me kolegët, duke përdorur inteligjencën emocionale; - të zbatojë standardet e sjelljes profesionale, gjatë komunikimit; - të zbatojë rregullat e higjienës, gjatë komunikimit me eprorët dhe kolegët; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Demonstrim. - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi identifikon problematikën në vendin e punës, si dhe aftësitë për zgjidhjen e tij. Kriteret e vlerësimit:	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të identifikojë llojin e problemit që ka hasur në vendin e punës;
- të grumbullojë informacionin e nevojshëm në lidhje me problematikat;
- të përpunojë informacionin e grumbulluar;
- të përcjellë informacionin në mënyrë efektive;
- të bashkëpunojë me kolegët për zgjidhjen e problemit;
- të menaxhojë emocionet;
- të demonstrojë etikë, gjatë trajtimit të problemit në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

RN 3 Nxënësi zgjidh problemet në mjedisin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të vlerësojë aspektin kulturor të problemit;
- të përcaktojë dukuritë që e shoqërojnë problemin;
- të përcaktojë rëndësinë e problemit;
- të përcaktojë rolin e secilit prej faktorëve që kanë shkaktuar problemin;
- të për zgjedhë mënyrën e duhur për trajtimin e problemit;
- të kryejë një analizë konstruktive;
- të ofrojë zgjidhje intuitive dhe ide në varësi të problemit;
- të transmetojë energji pozitive;
- të bashkëpunojë në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve, duke mirëpritur çdo këshillë dhe kritikë si një shtysë për të përmirësuar performancën personale dhe të grupit të punës;
- të argumentojë në formë të ndryshme (me gojë, me shkrim) qëndrimin e vet për problemin e identifikuar;
- të prezantojë qëndrimin e tij/saj, duke përdorur drejt gjuhën e shprehur ose të shkruar;
- të ndërmjetësojë mes palëve, duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- të përdorë instrumentet ligjorë, kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë në fokus zgjidhjen e problematikave të ndryshme në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjedise reale të punës në biznes/ zyrave mësimore.

dhe për vlerësimin e nxënësve	- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të vërë në dispozicion të nxënësve legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve dhe të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarrit etj, si dhe evakuimit të punonjësve. - Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, si komunikimi me eprorët dhe kolegët, identifikimi i problematikave në vendin e punës, si dhe zgjidhja e problemeve profesionale. - Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve të zyrës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Standardet ndërkombëtare të punës (konventat). - Kuadri shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë. - Kodi i punës. - Kodi etik. - Rregullore të brendshme. - Kompjuter.

8. Moduli “Procedurat për rastet e dyshimta”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROCEDURAT PËR RASTET E DYSHIMTA	M-17-2190-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procedurat për rastet e dyshimta, duke respektuar politikat për parandalimin e pastrimit të parave (AML), si dhe ruatjes së konfidencialitetit, gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12-të, të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi identifikon rastet e dyshimta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të mirëpresë klientin e të evidentojë kërkesën e tij; - të kryejë identifikimin e klientit përmes një dokumenti të vlefshëm identifikimi (ID kartë, pasaportë) dhe t'a fotokopjojë atë; - t'i kërkojë informacion të plotë klientin për veprimin që ai do të kryejë; - të kontrollojë dokumentacionin që ka dorëzuar klienti për të siguruar që të dhënat janë të plota dhe të sakta; - të identifikojë aktivitetet ose transaksionet e konsideruara si të pazakonta ose të dyshimta; - të kërkojë dokumente shtesë, si prova të burimit të fondeve ose qëllimit të transaksionit; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë identifikimit të rasteve të dyshimta. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi përgatit raportin për rastet e dyshimta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të plotësojë informacionin për klientin e dyshimtë (emrin	

- e plotë të klientit, numrin e llogarisë, adresën dhe kontaktet, statusin e klientit);
- të përshkruajë transaksionin e dyshimtë, duke përmbledhur në të datën dhe orën e transaksionit, llojin e transaksionit, shumën, metodën e realizimit të transaksionit, destinacionin e parave, origjinën e fondeve;
- të përshkruajë arsyet për dyshimin e transaksionit;
- të bashkëpunojë me kolegët dhe menaxherët për trajtimin e rastit të dyshuar;
- të përpunojë informacionin e grumbulluar;
- të përcjellë informacionin në mënyrë efektive;
- të bashkëpunojë me kolegët për zgjidhjen e problemit;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes së raportit për rastet e dyshimta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontroll i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi ruan konfidencialitetin, gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ruajë në mënyrë të sigurt dhe të papërshkueshëm nga palë të paautorizuara, çdo informacion të mbledhur rreth transaksioneve të dyshimta;
- të mbajë informacionin e klientëve të dyshuar ose kompanisë, të fshehtë dhe të sigurt;
- të përdorë sistemet e sigurisë së bankës/ institucionit financiar për mbrojtjen e informacionit;
- të kryejë procedurat për ruajtjen e informacionit në mënyrë të sigurt;
- të përdorë kanalet e komunikimit të koduar ose të sigurt, për të shmangur zbulimin e informacionit të ndjeshëm;
- të zbatojë legjislacionin për ruajtjen e konfidencialitetit;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë ruajtjes së konfidencialitetit, gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare. - Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer procedurat për rastet e dyshimta, duke respektuar politikat për parandalimin e pastrimit të parave (AML), si dhe ruatjes së konfidencialitetit, gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer procedurat për rastet e dyshimta, duke respektuar politikat për parandalimin e pastrimit të parave (AML), si dhe ruatjes së konfidencialitetit, gjatë trajtimit të rasteve të dyshimta. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Mjediset në shkollë dhe në biznes. - Kompjuter me akses interneti. - Programe kompjuterike. - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj. - Mjete kancelarie. - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

10. Moduli “Siguria fizike dhe operacionale në bankë”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SIGURIA FIZIKE DHE OPERACIONALE NË BANKË	M-17-1590-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimet e duhura gjatë dhe pas një grabitjeje, veprimet në rast alarmi, administrimin e çelsave dhe kodeve, si dhe për ruajtjen e sekretit bankar, në mënyrë të sigurt dhe profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	42 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12-të, të kualifikimit profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton standardet e sigurimit teknik, në punë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik në bankë/institucion financiar; - të monitorojë vlefshmërinë e dokumentacionit teknik, sipas rregullores së institucionit; - të zbatojë protokollet e duhura në rastet e ngjarjeve të ndryshme; - të zbatojë rregullat e sigurisë për përpunimin e cash-it në sportel; - të zbatojë procedurat e numërimit dhe verifikimit të cash-it; - të përdorë pajisjet e sigurisë të vëna në dispozicion nga banka, për të shmangur mashtrimet; - të mbajë vlerat monetare ditore në arkë, sipas udhëzimeve përkatëse; - të vendosë në kasafortën qendrore vlerat që nuk janë të nevojshme për shërbimin ndaj klientit; - të verifikojë limitin e Cash-it në kasafortën ditore, si dhe të sigurohet që nuk e tejkalon atë; - të ndërpresë veprimet dhe të marrë masa për dërgimin në kasafortën qendrore të vlerave që tejkalojnë limitin në kasafortën ditore; - të mos mbajë të ekspozuara vlerat monetare mbi banak, pas përfundimit të veprimeve me klientin;	

- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përpunimit të Cash-it në sportel, sipas rregullave të sigurisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen veprimet e duhura gjatë një grabitjeje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të ruajë qetësinë dhe të mos bëjë lëvizje të papritura që mund të provokojnë grabitësit;
- të ndjekë udhëzimet e grabitësve pa kundërshtuar për të shmangur përshkallëzimin e sigurt dhe vënien në rrezik jetën e tij/saj apo të të tjerëve;
- të vëzhgojë grabitësin /grabitësit, duke vënë re rrobat, bizhuteritë, ndonjë shenjë apo tatuazh, gjatësinë dhe peshën e përafërt, si dhe karakteristikat e tjera identifikuese;
- të mbajë të sigurt nga grabitësit dhe të shmangë çdo përpjekje për të ndaluar ata fizikisht;
- të aktivizojë alarmin për të njoftuar autoritetet dhe për të paralajmëruar të tjerët për rrezikun;
- të ndihmojë në evakuimin e sigurt të klientëve dhe të tjerëve nga zona e rrezikut, nëse është e mundur;
- të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse mbi sigurinë në bankë, sapo grabitësi të jetë larguar nga banka;
- të evidentojë me kujdes drejtimin në të cilin largohet grabitësi, mënyrë absolute jo duke e ndjekur atë;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve të duhura, gjatë një grabitjeje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen veprimet pas një situatë grabitjeje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të komunikojë me etikë profesionale;
- të njoftojë strukturën përgjegjëse mbi sigurinë në bankë, duke dhënë informacion për kohën e grabitjes, adresën e bankës dhe çdo lloj shenje identifikimi që mund të ketë lidhje me grabitësit, drejtimin që morën për t'u larguar etj;
- të sigurojë mjedisin dhe të ndihmojë klientët/kolegët që

- mund të jenë të tronditur;
- të njoftojë urgjencën në rast se dikush është dëmtuar dhe ka nevojë për ndihmë mjekësore;
- të afishojë një njoftim në derën kryesore për t'u bërë të ditur klientëve se banka është përkohësisht e mbyllur, duke i orientuar ata në degën tjetër më të afërt;
- të ndihmojë, kolegët/klientët për të bashkëpunuar me autoritetet përkatëse në dhënien e dëshmisë mbi ngjarjen;
- të marrë emrin dhe numrin e telefonit të ndonjë klienti që ngulmon të largohet për t'ia bërë të ditur;
- të mbrojë zonat ku kanë prekur grabitësit, në mënyrë që të ruhen shenjat e gishtërinjve apo shenjat e këpucëve që mund të kenë lënë grabitësit;
- të heqë tabelat me emrat e punonjësve (bexhet) për të ruajtur anonimin e tyre;
- të dokumentojë detajet e ngjarjes, duke përfshirë përshkrimin e grabitësve, numrin e tyre, dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve pas një situatë grabitjeje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen veprimet në rast alarmi, administrimin e çelsave dhe kodeve, si dhe për ruajtjen e sekretit bankar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë zonat e sigurisë në bankë (daljet e emergjencës, zonat e evakuimit, shkallët e mergjencës etj);
- të përdorë llojet e alarmeve në varësi të llojit të rrezikut;
- të ruajë qetësinë dhe të mos bëjë lëvizje të papritura që mund të shkaktojnë panik, në rast të ndonjë alarmi;
- të përdorë pajisjet e mbrojtjes ndaj zjarrit;
- të ndihmojë në evakuimin e sigurt të klientëve apo personave të tjerë nga zona e rrezikut;
- të zbatojë procedurat e duhura për menaxhimin dhe administrimin e çelsave dhe kodeve në bankë;
- të dorëzojë çelësat te kolegët e tjerë, duke plotësuar formularin respektiv të marrjes në dorëzim;
- të kujdeset për ruajtjen e konfidencialitetit, duke mos nxjerrë informacionin e klientit dhe informacionin e vetë bankës te persona të paautorizuar;
- të përdorë teknologjinë e enkriptimit për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurimin e konfidencialitetit të informacionit;
- të ruajë sekretin sigurt dhe administrimin e informacionit

sensitive;

- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së veprimeve në rast alarmi, administrimin e çelsave dhe kodeve, si dhe ruajtjen e sekretit bankar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer veprimet e duhura gjatë dhe pas një grabitjeje, veprimet në rast alarmi, administrimin e çelsave dhe kodeve, si dhe për ruajtjen e sekretit bankar, në mënyrë të sigurt dhe profesionale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer veprimet e duhura gjatë dhe pas një grabitjeje, veprimet në rast alarmi, administrimin e çelsave dhe kodeve, si dhe për ruajtjen e sekretit bankar, në mënyrë të sigurt dhe profesionale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.
-

X. Përshkruesit e moduleve me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Kuadrimi ditor i arkës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KUADRIMI DITOR I ARKËS	M-17-779-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procedurat e llogaritjes ditore të gjendjes së arkës, kuadrimit të saj dhe në rast diferencash sistemimin e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi llogarit gjendjen faktike të arkës së bankës dhe e dokumenton atë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të kryejë saktë procedurat e mbylljes së arkës në fund të ditës; - të numërojë fizikisht cash-in që ndodhet në arkë (para të gatshme), duke përfshirë monedha dhe bankënota; - të hartojë procesverbalin e mbylljes së arkës; - të grupojë cash-in gjendje në arkë, sipas llojit të valutës dhe prerjes përkatëse; - të hartojë saktë procesverbalin e gjendjes së arkës në fund të ditës, duke përfshirë lëvizjet e ditës (depozita dhe tërheqje), më vete për secilën prej valutave; - të pasqyrojë prerjet përkatëse të monedhave; - të llogarisë saktë gjendjet faktike, sipas valutave dhe pasqyrojë ato në procesverbal; - të identifikojë gabimet, gjatë regjistrimit të transaksioneve, si dhe t'i korrigjojë menjëherë në se rezultojnë të tilla; - të përditësojë regjistrimet në sistemin e bankës; - të firmosë procesverbalin dhe kryejë procedurën e saktë të dorëzimit të tij, së bashku me cash-in gjendje në degën e thesarit të bankës. - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të	

veprimtarisë profesionale;

- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë llogaritjes së gjendjes faktike të arkës së bankës dhe e dokumenton atë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi llogarit gjendjen e arkës së bankës, si dhe diferencat eventuale me ato faktike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të llogarisë saktë shumën e hyrjeve ditore të arkës për çdo lloj valute, sipas mandatarkëtimeve të saj;
- të llogarisë saktë shumën e daljeve ditore të arkës, për çdo lloj valute, sipas mandatpagesave të saj;
- të mbartë saktë në librin e arkës (në formë elektronike ose letër) hyrjet e daljet ditore sipas valutave dhe dokumenteve përkatëse, duke evidentuar edhe prerjet përkatëse të kartëmonedhave;
- të regjistrojë saktë në librin e arkës (në formë elektronike ose letër) mandatarkëtimin e parë të ditës për cash-in, sipas valutave të marra në dorëzim nga dega e thesarit të bankës (në se nuk është bërë në mënyrë elektronike krahas kryerjes së çdo veprimi);
- të llogarisë saktë gjendjen e arkës, në fund të ditës, sipas dokumenteve, për secilën prej valutave me të cilat ka pasur veprime;
- të krahasojë shifrën që është regjistruar në sistemin e bankës (gjendja e arkës e regjistruar) dhe shifrën që ka dalë nga numërimi fizik i parave (gjendja faktike), të detajuar sipas faturave;
- të kryejë kontrollin e përsëritur dhe të kryqëzuar të llogaritjes së gjendjes, sipas dokumenteve, në rast të konstatimit të diferencave;
- të korigjojë gabimin e gjetur në llogaritjen e tepricës, sipas dokumenteve, në se verifikohet një i tillë dhe llogarisë gjendjen e saktë të arkës;
- të kryejë kontrollin e saktë e të detajuar të gjendjes faktike sipas prerjeve, me hyrjet e daljet e parave sipas prerjeve, në rast të diferencave;
- të përgatitë njoftimet për klientët dhe dërgojë atyre, në se nga kontrolli i prerjeve rezultojnë gabime në marrëdhënie me ta;
- të shpjegojë shkakun dhe veprimet e ndërmarra, duke siguruar një evidencë të plotë dhe transparente të ndryshimeve të bëra;
- të hartojë, firmosë dhe dorëzojë procesverbalet në zyrën e llogarisë për diferencat që rezultojnë nga kontrolli;

- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë llogaritjes së gjendjes së arkës së bankës, si dhe diferencat eventuale me ato faktike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi sistemon diferencat në rast kur ato i ngarkohen arkëtarit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontabilizojë saktë diferencat negative në arkë në ngarkim të arkëtarit;
- të kontabilizojë saktë diferencat pozitive të arkës në ngarkim të rezultatit të bankës;
- të kontabilizojë saktë, në llogari të përkohshme, diferencat e arkës për të cilat është evidentuar burimi i gabimit, në përputhje me rregullat e brendshme të bankës;
- të kontabilizojë saktë korigjimin e gabimit dhe mbylljen e llogarisë së përkohshme në rastin, kur diferenca në arkë rivendoset;
- të kontabilizojë saktë mbylljen e llogarisë së përkohshme në rastin, kur diferencat nuk rivendosen dhe i ngarkohen arkëtarit ose rezultatit pozitiv të bankës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë sistemimit të diferencave në rast kur ato i ngarkohen arkëtarit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi sistemon diferencat në rast kur ato i ngarkohen rezultatit të bankës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontabilizojë saktë diferencat pozitive, ose negative të arkës në llogari pezull, në pritje të evidentimit të gabimit dhe rivendosjes së gjendjes në arkë;
- të paraqesë qartë, në bilancin e fundit të vitit, diferencat pozitive ose negative në arkë, për të cilat nuk ka mbërritur ende afati i parashkrimit;
- të kontabilizojë saktë, në ngarkim të rezultatit të bankës, diferencat pozitive ose negative në arkë, pasi është parashkruar e drejta e kërimit të tyre, duke i xhiruar nga llogaria e përkohshme;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të

veprimtarisë profesionale;

- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë sistemimit të diferencave në rast kur ato i ngarkohen rezultatit të bankës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer procedurat e llogaritjes ditore të gjendjes së arkës, kuadrimin e saj dhe në rast diferencash sistemimin e tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer procedurat e llogaritjes ditore të gjendjes së arkës, kuadrimin e saj dhe në rast diferencash sistemimin e tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.
-

2. Moduli “Studimi i tregut bankar”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	STUDIMI I TREGUT BANKAR	M-17-781-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të zbatuar parimet dhe teknikat e kërkimeve të tregut në sektorin bankar.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi për zgjedh teknikat e përshtatshme të kërkimit të tregut. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të interpretojë situatën aktuale në fushën e tregut bankar, për të cilin do të kryhet studimi; - të kryejë llogaritjet e duhura për kostot dhe kohën e nevojshme për kryerjen e studimit; - të përzgjedhë teknikën e studimit të egut në përputhje me objektivat dhe specifikimet e kërkimit; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përzgjedhjes së teknikave të përshtatshme të kërkimit të tregut. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi kryen studimin e tregut bankar të depozitave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë bankat, që do të jenë objekt i studimit; - të hartojë listat konkrete të detyrave që do të kryhen për realizimin e studimit; - të grumbullojë informacione mbi llojet e depozitave, që ofrojnë bankat; - të marrë informacione mbi normat e interesave, sipas llojeve të tyre në çdo bankë; - të përmbledhë informacionet e siguruar në pasqyra përmbledhëse krahasuese;

- të nxjerrë përfundime sipas bankave mbi veprimtaritë e tyre në funksionin e mbledhjes së parave dhe shumëllojshmërisë së këtij tregu;
- të analizojë informacionet e siguruar mbi depozitat bankare;
- të nxjerrë përfundime mbi llojet e depozitave, sipas bankave dhe leverdishmërinë e përdorimit të tyre, si dhe tendencat e tregut bankar në fushën e depozitave;
- të paraqesë në mënyrë të plotë dhe të saktë raportin e studimit të kryer;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë studimit të tregut bankar të depozitave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen studimin e tregut bankar të kredive.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë bankat, që do të jenë objekt i studimit;
- të hartojë listat konkrete të detyrave që do të kryhen për realizimin e studimit të tregut bankar të kredive;
- të marrë dhe paraqesë informacione mbi llojet e kredive, që ofrojnë bankat dhe normat përkatëse të interesave, sipas llojeve;
- të grupojë informacionet e siguruar në pasqyra përmbledhëse krahasuese;
- të analizojë informacionet e siguruar e paraqitura në pasqyrat përmbledhëse;
- të gjykojë mbi shkallën e shumëllojshmërisë së tregut të kredive në tregun bankar shqiptar;
- të krahasojë, sipas bankave, normat konkrete të interesave për lloje të ndryshme kredie me normat përkatëse të tregut, si dhe lehtësitë që ofrojnë bankat e veçanta në varësi të nevojave të klientit lidhur me interesat, komisionet e administrimit.
- të nxjerrë përfundime mbi llojet e kredive, sipas bankave dhe interesave përkatëse, leverdishmërinë sipas llojeve dhe bankave, si edhe tendencat e tregut bankar në fushën e kredive;
- të studiojë ndikimin e normave të interesit të Bankës Qendrore në ofertën e kredive;
- të paraqesë informacionin e përpunuar në formatin e duhur dhe në mënyrë të përmbledhur;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë

studimit të tregut bankar të kredive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen studimin sasior dhe cilësor mbi përdorimin e e-banking.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë bankat, që do të jenë objekt i studimit;
- të hartojë listat konkrete të detyrave që do të kryhen për realizimin e studimit;
- të marrë dhe paraqesë informacione mbi llojet përdorimin e shërbimeve e-banking, që ofrojnë bankat për klientët e tyre;
- të marrë informacione nga klientët rreth përvojës së tyre me banka të ndryshme;
- të përmbledhë informacionet e siguruar në pasqyra përmbledhëse krahasuese;
- të analizojë informacionet e siguruar;
- të studiojë shumëllojshërinë e shërbimeve të ofruara nga bankat nëpërmjet e-banking për klientët e tyre;
- të studiojë tendencat në bankungun elektronik dhe përdorimin e kartave të kreditit/debitit;
- të përcaktojë shkallën e leverdisshmërisë ekonomike të shërbimeve e-banking të ofruara nga bankat;
- të prezantojë informacionin e përpunuar në formatin e duhur dhe në mënyrë të përmbledhur;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë studimit sasior dhe cilësor mbi përdorimin e e-banking.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen studimin e tregut bankar mbi shkallën e transparencës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë bankat, që do të jenë objekt i studimit;
- të hartojë listat konkrete të detyrave që do të kryhen për realizimin e studimit;
- të vëzhgojë në banka mënyrën se si janë shkruar dhe paraqitur në vende të dukshme informacionet mbi kushtet e ndryshme të bankës, si dhe informacionet në website-t e tyre;
- të vëzhgojë dhe mbajë shënime për mënyrën se si punonjësit e bankave të ndryshme komunikojnë me klientët;

- të analizojë kohën mesatare të kontaktit të punonjësit të bankave të ndryshme me klientin dhe evidentojë përparësitë dhe të metat e kontakteve të shkurtra ose të gjata;
- të analizojë nivelin e transparencës së materialeve të shkruara të parapregatitura ose jo, që i vihen në dispozicion pa pagesë klientit nga banka;
- të nxjerrë përfundime mbi shkallën e aksesueshmërisë në informacion mbi normat e interesit dhe tarifat, qartësinë e kontratave bankare dhe kushtet e përdorimit;
- të analizojë ndikimin e transparencës në besimin e klientëve;
- të prezantojë informacionin e përpunuar në formatin e duhur dhe në mënyrë të përmbledhur;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë studimit të tregut bankar mbi shkallën e transparencës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës dhe bankë/ institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të zbatuar parimet dhe teknikat e kërkimeve të tregut në sektorin bankar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të zbatuar parimet dhe teknikat e kërkimeve të tregut në sektorin bankar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Mjete komunikimi si E-Mail, telefon, etj.
 - Mjete kancelarie.
 - Formularë model të hartuar nga vetë nxënësit.

3. Moduli “Marketingu digjital”

Kualifikimi profesional: “Shërbime bankare”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	MARKETINGU DIGJITAL	M-26-1580-19
Qëllimi i modulit	Një modul që pajis nxënësit me njohuritë dhe aftësitë bazë për të mundësuar marketingun e biznesit përmes teknikave të ndryshme digjitale.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procesi i vlerësimit	RN 1 Nxënësi përzgjedh platformën digjitale dhe mediat sociale për promovimin digjital. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të: – të analizojë produktin të cilit do ti bëhet marketingu; – të analizojë veçoritë e kategorive të klientëve të mundshëm të produktit; – të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediae sociale; – të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale; – të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale; – të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi përgatit materialet për hedhjen e tyre në platformën digjitale dhe median sociale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.); – të ndërtojë video, duke përdorur programe (softëare) të ndryshme (psh. <i>Movie maker</i>, ose nëpërmjet aparatit celular, <i>smartphone</i> etj.); – të modifikojë imazhe të ndryshme me <i>softëare: photoshop, canva</i> etj.; – të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën	

digjitale dhe median sociale të përzgjedhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi menaxhon platformën digjitale e mediat sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë gabimet e mundshme në materialet e ndryshme interaktive të hedhura në platformën digjitale dhe median sociale;
- të modifikojë materialet e ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.) në rast gabimesh;
- të fshijë materiale interaktive të panevojshme në platformën digjitale dhe mediat sociale;
- të realizojë komunikimin digjital me ndjekësit/klientët, përmes internetit/mesazheve në inbox ose komenteve për materialet e publikuara në platformën digjitale;
- të monitorojë impaktin e mesazhit të kompanisë te ndjekësit/klientët;
- të nxitë ndjekësit/ klientët që të veprojnë në përgjigje të mesazhit të kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përgatit raporte të dhënash mbi përdorimin e platformës digjitale dhe mediave sociale nga ndjekësit/klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë numrin e vizitorëve të platformës digjitale dhe mediave sociale;
- të ndërtojë një paraqitje grafike mbi numrin e vizitorëve që aksesojnë platformën digjitale dhe mediat sociale (ditore, javore, mujore);
- të evidentojë disa prej elementeve psikologjikë të *Marketingut Super Efektiv* nëpërmjet internetit/rrjeteve sociale (të cilët bëjnë diferencën midis një fushate të pasuksesshme dhe një fushate jashtëzakonisht të suksesshme);
- të analizojë rolin e menaxherit të platformës digjitale dhe mediave sociale, duke u bazuar te numri i personave që i aksesojnë ato.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi krijon një plan marketingu digjital.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me publikimin/ shpërndarjen e informacioneve të ndryshme në

platformat e përzgjedhura;

- të krijojë fushata marketingu digjital, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose *mobile marketing*);
- të identifikojë fushata fituese, si dhe të mirëmbajë fushatat ekzistuese të marketingut për sukses maksimal;
- të sugjerojë, nëse është e mundur, zgjidhje të mirëfillta, të shumëllojshme dhe të mirëanalizuara për arritjen e perceptimit të mesazhit deri te audienca e synuar dhe konsumatori final.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës dhe institucione financiare.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të mundësuar marketingun e biznesit përmes teknikave të ndryshme digjitale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënës, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të mundësuar marketingun e biznesit përmes teknikave të ndryshme digjitale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Mjediset në shkollë dhe në biznes.
 - Kompjuter me akses interneti.
 - Programe kompjuterike.
 - Pajisje për përgatitjen e materialeve promovuese.
 - Informacione mbi marketingun digjital.
 - Legjislacioni mbi marketingun digjital.
 - Materiale udhëzuese.
-

XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.

Programi orientues për provimet përfundimtare në Kualifikimin Profesional ”Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë për Kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe të 13-të, që i përket këtij niveli, sipas Skeletkurrikulit përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë janë si më poshtë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	- Të zbatojë procedurat e sigurisë në çelje dhe mbyllje të arkës. - Të kuadrojë gjendjet monetare. - Të kryejë çeljen dhe mbylljen e arkës, sipas procedurave.	Detyra 1: Veprime në çelje dhe mbyllje të arkës.	30
2	- Të identifikojë elementet e sigurisë në monedha dhe kartëmonedha të ndryshme. - Të kryejë procedurat e sistemimit të cash-it. - Të kryejë sortimin e valutave.	Detyra 2: Veprime me cash-in.	30
3	- Të kryejë veprimet për çeljen e llogarive të ndryshme të klientëve. - Të plotësojë dokumentacionit e aplikimit për kredi të klientit. - Të vlerësojë aftësinë paguese të kredimarrësit. - Të kryejë veprime me çeket e pranuar nga klientët e bankës. - Të kryejë veprime me kurset e këmbimit. - Të informojë klientin për mënyrën si funksionon fondi i investimit dhe letrat me vlerë të shtetit shqiptar.	Detyra 3: Veprimet në shërbime bankare.	40
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 – 40	4
41 – 50	5
51 – 60	6
61 – 70	7
71 – 80	8
81 – 90	9
91 – 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me **“detyrë pune”** individuale, në mjediset e zyrave mësimore.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është e **domosdoshme dhe shumë e rëndësishme** që për çdo detyrë, qysh në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësimdhënësit t’i kushtohet vëmendje **“orientimit të nxënësve në lidhje me situatat e dhëna”**, gjatë gjithë kryerjes së detyrave dhe për çdo nxënës.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatitë instrumentet përkatëse të vlerësimit, sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit disa modele tezash provimi, ku për çdo tezë detyrat janë të njëjta, por me situata dhe të dhëna të ndryshme, ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërin prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatitë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Për realizimin e **detyrës 1**, nxënësi do të vlerësohet në mënyrë individuale në mjediset e zyrave mësimore, ku aktualisht do të simulohen proceset e mësipërme. Nxënësi duhet të listojë veprimet e domosdoshme në zbatim të procedurave të sigurisë në çelje dhe mbyllje të arkës. Nxënësi me anë të simulimit duhet të kuadrojë gjendjen e arkës. përmes formularëve dhe printimeve të valutave të ndryshme të vëna në dosjen e praktikës. Nxënësi duhet dokumentojë rastet e mospërputhjeve të shumave fizike me dokumentacionin përkatës, si dhe të pëshkruajë hapat e procedurës për veprimet korrigjuese dhe raportimin e tyre.

Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetje në lidhje me procesin e çeljes dhe mbylljes së arkës, si dhe dokumentacionin përkatës që plotësohet për diferencat e mundshme të gjendjes në sistem me atë fizike.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha etapat e procesit të realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Për realizimin e **detyrës 2**, nxënësi do të vlerësohet në mënyrë individuale në mjediset e zyrave mësimore, ku aktualisht do të simulohen proceset e mësipërme. Nxënësi duhet të përmbushë detyrën, duke plotësuar disa kërkesa të një ushtrimi përmbledhës. Nëpërmjet simulimit, nxënësi duhet të listojë dhe pëshkruajë elementet e sigurisë në monedha dhe kartëmonedha të ndryshme. Nxënësit i kërkohet të sistemojë bankënota modele të ndryshme si pjesë e dosjes së praktikës, si dhe të plotësojë dokumentet e nevojshme për depozitimin dhe transferimin e cash-it. Nxënësi duhet të listojë pajisjet e nevojshme për sortimin e valutave dhe pëshkruajë procedurën e ndjekur në përdorimin e tyre. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetje në lidhje me pikat kyçe të detyrës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve (me listë kontrolli), duhet të vihet theksi te aftësia për të zbatuar masat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit, gjatë procedurave të sistemimit të cash-it.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, listë e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Për realizimin e **detyrës 3**, nxënësi do të vlerësohet në mënyrë individuale në mjediset e zyrave mësimore, ku aktualisht do të simulohen proceset e mësipërme.

Nxënësi duhet të kryejë veprime për çeljen e llogarive të ndryshme, veprime me çeqet e pranuar nga klientët e bankës, si dhe veprime me kurset e këmbimit.

Nxënësi mund të simulohet, në lidhje me kërkesën e një individi/biznesi për kredi, duke krijuar një ushtrim. Konkretisht nxënësit i vihen në dispozicion të dhëna të tilla si: shuma totale e kredisë, kësti vjetor, paga vjetore, shpenzimet vjetore, afati i shlyerjes, norma e interesit, të ardhurat. Nxënësit mund t'i jepen të listuara të gjitha dokumentet e nevojshme për t'u paraqitur nga aplikanti (indiv/biznes), por mund dhe t'i jepen një pjesë e tyre dhe ai duhet të plotësojë listën e nevojshme me dokumentet e munguara.

Nëpërmjet bashkëbisedimit profesional, nxënësi informon “klientin” për mënyrën si funksionon fondi i investimit dhe letrat me vlerë të shtetit shqiptar.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, listë e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Rekomandohet që secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi për çdo kompetencë dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse.